



Ky libër që kemi në dorë ka një histori më vete. Relacioni i ipeshkvit Vincenc Zmajević i vitit 1702/1703 është vepër e tre autorëve: Vincenc Zmajević, Peter Bartl dhe Injac Zamputti. Zmajević e ka shkruar këtë relacion nga vizita apostolike në ipeshkvitë e Shqipërisë, Serbisë, Maqedonisë dhe Bullgarisë më 1702/1703. Këtë relacion e ka botuar italisht (versioni i arkivit të Vatikanit) Peter Bartl më 1979 në librin "Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte Im 17. Und 18. Jahrhundert" fq. 1-186, përcjellë me shpjegime e shënime nga Bartl. Shqip është përkthyer nga Injac Zamputti më 1988, përkthim i pabotuar deri tani.

A. Ramaj

Peter Bartl/Injac Zamputti

Vincenzo Zmajevich

Peter Bartl/Injac Zamputti

Vincenzo Zmajevich

Relacion i gjendjes së Shqipërisë e Serbisë
Relazione dello stato d'Albania e Serbia
(1702-1703)

Albert Ramaj (ed.)

albanisches
institut

FAIK KÖNICA

ISBN: 978-3-9524201-7-1

Peter Bartl/Injac Zamputti

Vincenzo Zmajevich

Relacion i gjendjes së Shqipërisë e Serbisë
Relazione dello stato d'Albania e Serbia
(1702-1703)

Albert Ramaj (ed.)

Peter Bartl/Injac Zamputti

Vincenzo Zmajevich

Relacion i gjendjes se Shqipërisë e Serbisë
Relazione dello stato d'Albania e Serbia
(1702-1703)



St. Gallen-Prishtinë 2022

Peter Bartl/Injac Zamputti

Vincenzo Zmajevich

Relacion i gjendjes se Shqipërisë e Serbisë
Relazione dello stato d'Albania e Serbia
(1702-1703)

Përgjegjës të këtij botimi:

Albert Ramaj
Zef (Ahmeti) Noka

© *Albanisches Institut*

© *Të drejtat e faksimileve të raportit origjinal të Zmajevichit i mbesin Arkivit të Vatikanit.*

Albanisches Institut
Postfach 7
CH-9001 St. Gallen
www.albanisches-institut.ch
info@albanisches-institut.ch

(CIP) Schweizerische Landesbibliothek
ISBN: 978-3-9524201-7-1

SHB Faik Konica
Rr. Ganimete Tërbeshi nr. 20
10000 Prishtinë
konica_faik@hotmail.com

(CIP) Biblioteka Kombëtare e Kosovës
"Pjetër Bogdani"
ISBN:

PËRMBAJTJA - INDICE

Relacioni i Vincenc Zmajević i vitit 1702/03 dhe rëndësia e tij për shqiptarët- <i>Albert Ramaj</i>	15
Njoftime të gjithëanshme mbi gjendjen e Shqipërisë dhe veprimtarisë së imzot Vincent Zmajevićit kryepeshkop i Tivarit vizitator apostolik i Shqipërisë -	23
Gjendja e lashtë dhe e sotme e kryepeshkopatës së Tivarit	36
Famullia e Varoshit të Tivarit.....	38
Famullia e Shushanit.....	39
Famullia e Shpiçit.....	40
Famullia e Kështjellës së Lastuas.....	40
Famullia e Briskës dhe e Shestanit.....	41
Gjendja e dioqezës së Shkodrës	43
Rrjoli.....	45
Kastratit.....	47
Hotit.....	49
Gruda	50
Selca e Kelmendit	51
Varoshit të Shkodrës.....	53
Oboti	54
Samrishit.....	55
Shasi.....	56
Shën Gjergjit	57
Pulaj	58
Trushi i Epër.....	60
Trushit të Poshtëm	61
Lagjakondit (Lagja e Kontit ?)	62
Barbullushi.....	62
Buzëgjarpëni.....	64
Beltojës	64
Jubanit.....	65
Nevoja dhe mjete për dioqezën e Shkodrës.....	66
Gjendja e Postribës	67
Gjendja e peshkopatës së Pultit	69

Plani	71
Shoshit	72
Toplana	73
Nevojat dhe mjetet që duhen për dioqezën e Pultit	75
Gjendja e peshkopatës së Sapës (Zadrimës)	76
Shkjezi	77
Babës	78
Pistulli	79
Mjedja	80
Hajmeli	81
Sapës apo Nenshatit	83
Troshani	84
Krytha	85
Gjadri	86
Blinishtit	86
Vjerdha	88
Pukës	89
Iballes	90
Nevoja dhe masa për dioqezën e Sapës	91
Gjendja e peshkopatës së Lezhës	91
Malit të Zi	93
Fandit të Vogël apo Fandës	95
Mirdita	95
Blinishtit	99
Dibri	102
Ndërfandë	103
Pëdhanës	104
Misioni i Etërve të Reformuar	105
Zejmeni	107
Bokjani	107
Gryka	109
Velja	110

Kallmeti	113
Merçija	114
Lezhës.....	115
Kuvendi i etërve observonte i Shën Mërisë që thuhet e Lezhës.....	116
Balldrenit	117
Kakarriqi	117
Nevoja dhe masa për dioqezën e Lezhës.....	118
Gjendja e kishës kryepeshkopore të Durrësit	118
Kurbinit	120
Skuraj.....	122
Bishkashi dhe Bazja.....	123
Kthella	124
Prellit	125
Dukagjinit	126
Misionit dhe famullisë së Macukullit.....	127
Selitës	128
Lurës.....	130
Misioni i Çidhnës i etërve të reformuar	130
Cudhinit.....	132
Bogomeshi.....	133
Derveni	133
Breti (Mbreti?).....	134
Zheja.....	135
Sebaste.....	136
Gurëzi	137
Belaj i poshtëm.....	137
Belaj të epërm.....	138
Rodoni.....	138
Lalëza.....	139
Mollëkuqit.....	140
Jubës.....	141
Durrësi	142
Nevojat e veçanta	142

Gjendja e kishës së Budues	142
Gjendja e kishave të Serbisë të administruara nga kryepeshkopi i Shkupit...	145
Shkupit.....	148
Janjeva.....	150
Jakovës apo Gjakovës.....	152
Hasit.....	154
Prizrenit	154
Misioni i Pejës	156
Peshtera.....	159
Nevojat dhe mjetet e shërimit për Serbinë që janë:	159
Gjendja e krishterimit të Bullgarisë.....	160
Daugjevos	161
Nikopoli	161
Masa të përgjithshme për Shqipërinë dhe Serbinë	161
Nevoja të përgjithshme për etërit misionarë	163
Nevoja dhe mjete për etërit observonte	163
Shënim i veçantë për famullitë, fshatrat, shtëpitë dhe frymët katolike, skizmatike (ortodokse), dhe turke (myslimane) që gjenden në secilën dioqezë të Shqipërisë	165
Fleta A	183
Raporti i Zmajevich-it në italisht – <i>Peter Bartl</i>	187
Stato antico, e moderno dell’Arciu.to d’Antiuari.....	197
Parochia del Borgo d’Antiuari	199
Parochia di Sussani	201
Parochia di Spizza.....	201
Parochia del Castel di Lastua	202
Parochia di Brischi, e Scestani	203
Stato della Diocesi di Scuttari	204
Rioli	207
Castrati.....	208
Hotti	210
Gruda	211
Selza di Clementi.....	212
Borgo di Scuttari	214

Obotti.....	215
Samarisci.....	215
Sciassi.....	216
S. Giorgio.....	218
Pulagni.....	219
Daici.....	220
Trumpsci Superiore.....	220
Trumpsci Inferiore.....	221
Lagiacondit.....	222
Barbulusci.....	223
Busigerpani.....	224
Beltogna.....	224
Jubbani.....	225
Bisogni e rimedij per la Diocesi di Scuttari.....	226
Stato di Posterippa.....	227
Stato del Vescouato di Pulati.....	228
Planti.....	230
Sciossi.....	231
Toplana.....	232
Bisogni e rimedij per la Diocesi di Pulati.....	234
Stato del Vescouato di Sappa.....	234
Schiesi.....	236
Babba.....	237
Pistuli.....	238
Mietia.....	239
Haimelli.....	239
Sappa, ò Ndenesciati.....	241
Trosciani.....	242
Crutha.....	243
Giadri.....	243
Bliniscti.....	244
Vierda.....	245
Puka.....	246

Ibalea	247
Bisogni, e rimedij per la Diocesi di Sappa	248
Stato del Vescovato d'Alessio	248
Monte Negro	250
Fandi piccolo, ò Fandia.....	251
Merediti	252
Bliniscti.....	255
Caccinari.....	256
Dibri	257
Nderfandina	258
Pedana.....	259
Missione de PP. Riformati	260
Zoimeni.....	261
Bocchiani.....	262
Salomundi.....	263
Grucha	264
Veglia	264
Noi Giorgio oVladagni per la grazia di Dio, e della Sede Apostolica Vescouo d'Alessio.....	265
Giorgio Vladagni Vesc.o d'Alessio	265
Calameti.....	266
Merchigna.....	267
Alessio	268
Con(uen)to de PP. Osseruanti di S.ta Maria detta d'Alessio	269
Baldreni	270
Caccarichi.....	270
Bisogni, e Rimedij per la Diocesi d'Alessio	271
Stato della Chiesa Archiepiscopale di Durazzo.....	271
Corbino	273
Scurragni.....	275
Biscasci, e Basia.....	275
Nchtella.....	277

Preli	278
Ducaggini	279
Missione, e Parochia di Mazzocoli	280
Selita	281
Luria.....	282
Missione di Chidena de PP. Rif.ti.....	283
Zedini.....	284
Bogomesci	285
Deruendi.....	286
Beretti.....	286
Xeia	287
Sebaste.....	288
Guresi	289
Belagni Infer.re.....	289
Belagni Super.re.....	290
Redoni	290
Lalesa.....	291
Molocucci	292
Juba.....	292
Durazzo.....	293
Li bisogni particolari.....	293
Stato della Chiesa di Budua	294
Stato delle Chiese di Seruia, amministrare dall'Arciuescouo di Scopia	296
Scopia	299
Jagneuo	301
Jakoua, ò Giacouiza	302
Hasso	304
Prisdren	305
La Missione di Pecchia.....	306
Pistera	309
Bisogni, e Rimedij per la Seruia, e sono.....	309
Stato della Christianità di Bulgaria.....	310

Dageuo.....	311
Nicopoli.....	311
Rimedij uniwersali per l'Albania, e Seruia	312
Bisogni uniwersali per li Padri Missionarij	313
Bisogni, e rimedij delli Padri Osseruanti.....	314
Nota distinta	315
Folium A.....	332
Shtojca	337
Testamenti i ipeshkvit Vinzenc Zmajević - <i>Lovorka Čoralić</i>	339
Kryeipeshkevi Vinzenz Zmajević dhe thirrja e Kuvendi Arbënit më 1703- <i>Peter Bartl</i>	353
Vinko Zmajevići (1670-1745) dhe kryeipeshkvia e Shkupit- <i>Frok Zefi</i>	369
Faksimile.....	403



Vincenc Zmajevich
(Museum Perast, marrë nga libri i P. Bartl)

Relacioni i Vincenc Zmajević i vitit 1702/03 dhe rëndësia e tij për shqiptarët

Hyrje

Ky libër që kemi në dorë ka një histori më vete. Relacioni i ipeshkvit Vincenc Zmajević i vitit 1702/1703 është vepër e tre autorëve: Vincenc Zmajević, Peter Bartl dhe Injac Zamputti. Zmajević e ka shkruar këtë relacion nga vizita apostolike në ipeshkvitë e Shqipërisë, Serbisë, Maqedonisë dhe Bullgarisë më 1702/1703. Këtë relacion e ka botuar italisht (versioni i arkivit të Vatikanit) Peter Bartl më 1979 në librin “Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte Im 17. Und 18. Jahrhundert“ fq. 1-186, përcjellë me shpjegime e shënime nga Bartl. Shqip është përkthyer nga Injac Zamputti më 1988, përkthim i pabotuar deri tani.

Vincenc Zmajević - relacioni i 1702/03 dhe Kuvendi i Arbënit 1703

Vincenc Zmajević ka lindur në Perast (Mali i Zi) më 23. 12. 1670 në një familje kroate e njohur në historinë e rajonit dhe më gjerë. Në shkrime të ndryshme ndeshim në disa variante shkrimi të emrit: p. sh. Vincenzo, Vincenc, Vinçenc, Vincent, Vicko, Visk, Vink, Vinko dhe Zmajević, Zmaievich, Zmajevich, Zmaieulich, Zmajeviq, Zmajevik, Zmajeviq... Në këtë libër kemi dy versione: në parafjalë është përdorur emri e mbiemri i tij siç e gjejmë në shumicën e shkrimeve internacionale Zmajević, kurse tek shkrimet e përkthyer kemi respektuar versionin që e shkruajnë përkthyesit: Vinçenc Zmajeviq dhe Vinko Zmajeviq, kurse titullin e kemi sipas versionit të dokumentit nga Arkivi i Vatikanit.

Xhaxhai i tij, Andrija Zmajević, ishte ipeshkëv i Tivarit (1671-1694). Me ndihmën e tij dërgohet në “*Collegium Urbanum*” në Romë, ku përfundon studimet në filozofi e teologji, doktoroi më 30. 03. 1695. Pas shugurimit meshtarak, më 1696 kthehet në vendlindje dhe emërohet famullitar në Perast. Më 1701 papa Klementi XI e emëroi ipeshkëv të Tivarit me dekretin: “Vicentius Zmajevich, archiep. Antibarensis 8 Iulii 1702 deput. visit. apost. ecclesiarum et missionum prov. Epiri seu Albaniae iuxta decr. S. Congr. Prop. 13 Iun. 1702 emanatum et a S.S. 19 Iun. 1702 approbatum”. Vincenc Zmajević ishte ipeshkëv i Tivarit deri sa u emërua ipeshkëv i Zarës në Kroaci, më 1713, ku edhe vdiq më 11.09.1745. Pas emërimit të tij ipeshkëv i Tivarit më 1701, Papa Klementi XI (Giovanni Francesco Albani) emëroi Zmajević Vizitator Apostolik në Shqipëri, Serbi, Maqedoni e Bullgari, dhe këtë vizitë e filloi në shtator të vitit 1702 e që zgjati deri në shkurt 1703. Për këtë vizitë ai

shkroi një relacion tejet të rëndësishëm për historinë shqiptare. Kjo vizitë ishte edhe pararoja e Kuvendit të Arbërit që u mbajt në Mërq, në janar 1703, të cilin e thirri Zmajević. Dorëshkrimi i Zmajević-it është i njohur me emrin “Notitie universali dello stato di Albania, e dell’operato da monsig.r Vincenzo Zmaievich arcivescovo di Antivari visitatore apostolico dell’Albania” (“Njoftime të gjithanshme mbi gjendjen e Shqipërisë dhe të veprimtarisë së imzot Vincent Zmajević kryepeshkop i Tivarit vizitator apostolik i Shqipërisë” - sipas përkthimit të Zamputti-t) dhe ruhet si dorëshkrim në dy versione (gati identike); njëri është në Bibliotekën Apostolike të Vatikanit, Barb.Lat 4577, dhe tjetri në arkivin e Propaganda Fide SC, Albania, 5. F. 535-661. Po ashtu edhe një pjesë e këtij relacioni është botuar nga Jovan Tomić “Gradja za istoriju gornje Arbanije (Spomenik Srpske Kraljevske Akademije” XLII, Beograd 1905, f. 61-72, të cilin Tomić e kishte blerë në Venedik nga një antikuarist. Kjo tregon se ishte edhe një tjetër version i këtij dorëshkrimi.

Relacioni i Zmajević-it i viteve 1702/03 është tepër i rëndësishëm për historinë shqiptare, por Zmajević duhet kujtuar edhe për dy ngjarje shumë të rëndësishme për historinë e popullit shqiptar: 1. Thirrja e Kuvendit të Arbrit më 1703 nga ana e tij, dhe 2. Shpërngulja e shqiptarëve në Arbanasi afër Zarës. Pasi Zmajević kishte vizituar si i dërguar i Vatikanit ipeshkvitë në Shqipëri, Maqedoni, Serbi e Bullgari, kishte parë gjendjen e mjerueshme të katolikëve shqiptarë, jo vetëm materiale por edhe organizative, strukturore nën perandorinë osmane... Prandaj e pa të arsyeshme që të ndërmarrë diçka konkrete për Kishën Katolike në trojet shqiptare. Kështu falë Zmajević-it u thirr dhe u organizua Koncili apo Kuvendi i Arbrit i cili u mbajt më 14 dhe 15 janar 1703 në Mërq në afërsi të Lezhës, ku u tubuan ipeshkvijtë e klerikët katolikë, apo më mirë të themi, përfaqësuesit kishtarë shqiptarë për të diskutuar dhe vendosur rregulla për jetën kishtarë në trojet shqiptare. Kuvendi i Arbrit kishte një frymë të koncilit të Trentit, i mbajtur qysh më 1545-1563. Dëshmi për punën e vyer të Zmajević për Koncilin e Arbrit 1703 mund të shihen në botimet e ndryshme të akteve të Koncilit. Këtu duhet përmendur vepra e A. Vinçenc Malajt “Kuvendi i Arbënit 1703” (Prishtinë 1998) për këtë temë.

Për termin *koncil* shpesh mund të përdorim edhe fjalën tjetër *sinodi*, që, në shekujt e parë të Kishës, kishte të njëjtën domethënie. Ky term, më vonë në Kishën perëndimore (latine) u zëvendësua me fjalën *koncil ekumenik*. Në fakt, kemi të bëjmë me të njëjtën gjë, përveç se termi *koncil* rrjedh nga latinishtja (*concilium*) kurse ai *sinod* (*synodos*) është fjalë greke. Në shqip mund të përdoret për këtë edhe emri *kuvend* apo *këshill*. Nganjëherë, në kohën e sotme, termi *sinod* përdoret për një mbledhje kishtarë të një rajoni apo ipeshkvië. Fjala *koncil* është fjalë

latine, dhe në shqip mund ta përkthejmë: mbledhje, tubim, pleqnim, kuvend, takim, pjekje. Në Kishën katolike ekzistojnë dy lloj koncilësh, ai *provincial (koncil partikular apo sinodi ipeshkvor)*, që përfshin një rajon apo një vend (shtet) dhe ipeshkvijtë që përfaqësojnë kishën vendore, dhe ai që përfshin Kishën e gjithmbarshme nën udhëheqjen dhe thirrjen e Papës, pra ku marrin pjesë të gjithë ipeshkvijtë katolikë të botës dhe quhet *koncil ekumenik*. Kuvendi i Arbrit është koncil partikular, i ftuar nga Vincenc Zmajević, gjithsesi me dijeni dhe leje të Papës Klementit XI. Sinode ipeshkvore apo ndëriveshkvore shqiptare kishte edhe më parë gjatë historisë kishtarë, por "Kuvendi i Arbrit" ishte me përmasa të mëdha, pasi për këtë ishte informuar mirë Papa Klementi XI dhe dokumentet e botuar pas Koncilit ishin të shumta, latinisht e pastaj edhe shqip, e që kanë interesa të ndryshëm studimi, kishtarë, historike, gjuhësore, etnografike... Një ndër koncilët shumë të rëndësishme të mëparshme në trojet ballkanike, ishte Koncili i Tivarit, i mbajtur më 1249/1250 që, për kohën, ishte shumë i rëndësishëm, apo sinodi diocezan në Letnicë, më 1642.

Relacioni i vitit 1702/03 i Zmajević nuk është me interes vetëm për historianët e shekullit XVII. Përmbajtja e tij do të mund të përshkruhet në pika të shkurtra kështu. Faqet e para ia kushton gjendjes jo vetëm historike shqiptare, por edhe asaj ekonomike, pozicionit gjeografik, dioqezave në trojet shqiptare, gjendjes së mjerueshme të të krishterëve nën sundimin otoman, por edhe kritikën ndaj klerit katolik nuk mungojnë. Në këtë pjesë, Zmajević shkruan se duhet thirrur një koncil provincial shqiptar, çka edhe bëri më 1703 (Kuvendi i Arbrit). Përshkrimet e Zmajević në këtë relacion janë detaje për kohën, jo vetëm për jetën e besimtarëve apo të klerikëve, për hapësirën gjeografike që ai vizitonte, për shkatërrimin e kishave, tjetërsimet nëpër kisha, por jep edhe numra të saktë të besimtarëve katolikë nëpër famulli. Në këtë kohë, siç dihet, islamizimi kishte shtrirë rrënjët jo pak në popullin shqiptar dhe jeta ishte tejet e vështirë jo vetëm për të krishterët, por edhe për ata që ishin islamizuar. Kishte edhe të tillë që, në brendi mbaheshin të krishterë, kurse jashtë si myslimanë. Ishin të krishterë të fshehtë, pra edhe çështja e apostazisë ishte temë në këtë relacion.

Relacioni trajton, me nga një kapitull të veçantë, dioqezat që ai vizitonte e ku jetonin katolikët, si ato të: Tivarit, Shkodrës, Pultit, Sapës, Lezhës, Administratën e Durrësit, Budues, gjendjen e kishave të Serbisë dhe Administratën e Shkupit, gjendjen e të krishterëve në Bullgari. Jep po ashtu edhe ide për dalje nga kjo gjendje e mjerueshme, nevojat e misionarëve françeskanë etj. Kur trajton dioqezat, jep me hollësi edhe informata për klerin e famullitë e dioqezave përkatëse.

Një ngjarje tjetër interesante nga veprimtaria e Zmajević është edhe shpërngulja e shqiptarëve në Arbanasi afër Zarës (Zadar) të Kroacisë. Ikja e tyre nga vendlindja ishte për shkak të jetesës së vështirë si katolikë nën sundimin otoman. Për jetën e Zmajević duhet pasur përherë parasysh autorët Daniele Farlati, Pavao Butorac, Peter Bartl, po ashtu edhe Lovorka Čoralić, Vinçenc Malaj... Zmajević ka botuar disa vepra, tekstet e kuvendit etj. P.sh. *“Corona poetica”*, *“Rasgouor Duhouni”*, *“Musarum chorus in laudem Antonii Zeni”*, *“Specchio della verità”* etj., por për ne janë të rëndësishme tekstet e Kuvendit të Arbënit në gjuhën latine që bëri Zmajević. Tentoi botimin e *„Ljetopis crkovni”* të Andrija Zmajević, por nuk arriti ta botonte. Zmajević ka lënë dorëshkrime që duhet hulumtuar sipas Čoralić, e cila ka botuar një libër me tema nga historia shqiptaro-kroate (Albanisches Institut në St. Gallen & Hrvatski Institut za povijest në Zagreb botuan më 2022) *“Odabrane teme iz povijesti albansko-hvatskih veza”* (shqip: Tema të zgjedhura nga historia e marrëdhënieve shqiptaro-kroate). Në këtë libër një pjesë jo të vogël ia kushton Zmajević, jetës dhe veprimtarisë së tij në Zarë, ku ruhet edhe testamenti i tij. Testamentin e Zmajević do ta sjellim në shtojcën e këtij libri. Është interesant se në testament Zmajević përmend një kryq që ia kishte dhuruar Papa Klementi XI. Po ashtu këtu kërkon nga Kongregacioni që të përkrahë ipeshkvijtë dhe misionarët shqiptarë, kërkon nga kolegji Urbanian që të ndihmojë për studime dhe të sigurojë libra për ta *„giovani provvedersi di qualche libro di più”*. Por në këtë testament është një fjali interesante kur thotë: *„e l’Albania Cattolica, che s’estende da Antivari sino a Durazzo”*. Këto gjëra do të jenë interesante për historianët.

Zmajević ishte ipeshkëv i Tivarit deri më 1713 dhe pastaj ishte ipeshkëv i Zarës deri në vdekjen e tij, më 1745. Shpërngulja e shqiptarëve në Arbanasi të Zarës u bë me ndihmën e përkujdesjen e Zmajević-it. Kjo shpërngulje nga pjesa e liqenit të Shkodrës filloi më 1726 dhe vazhdoi deri më 1733. Shqiptarët e shpërngulur në Arbanasi, atë vend e quanin *“Arbëneshi”*. I njohur në botën perëndimore është edhe emërtimi i tij Borgo Erizzo, që mori sipas gjeneralit venedikas Nicolò Erizzo, nga i cili Zmajević kishte kërkuar leje që t’i sistemonte të shpërngulurit shqiptarë në Zarë. Për këtë temë shih më shumë Tullio Erber dhe Kruno Krstić. Sipas Kruno Krstić, fëmija i parë shqiptar i pagëzuar është djali i Lekë Perës, më 3 maj 1726, me prejardhje nga Brisku, të cilin e pagëzoi kapelani i gjeneralit Erizzo. Zmajević ndërtoi me të hollat e veta kishën e Zojës Loreto për Arbëneshët e Zarës: pse pikërisht të Zojës? A mos ka të bëjë ndonjë paralele me Zojën e Shkodrës duhet hulumtuar. Zmajević kujdesej edhe për të shpërngulurit e tjerë katolikë shqiptarë. Kështu, për shpërnguljen e kelmendasve nga

vendlindja e tyre në Peshter, më 1705, Zmajević i shkruan Pashës së Pejës që në këtë grup të vepronë dy misionarë katolikë, por, kur kuptoi se kelmendasit kishin ikur, Zmajević “kurseu” misionarët françeskanë që të mos vriten nga turqit. Zmajević e njihte shumë mirë problemin e kelmendasve që kishin bërë rezistencë ndaj pushtuesve dhe se jeta e tyre ishte në rrezik. Kelmendasit u shpërngulën prej Peshterit në Sllavoni afër Osjekut, me ipeshkvin e Shkupit Mikel Summa në krye, të cilin Zmajević e kishte udhëzuar që të lëshojë ipeshkvinë e vet në Shqipëri, për shkak të gjendjes së vështirë në këtë territor. Shpërngulja e kelmendasve ndodhi më 1737 dhe, më vonë, për shpërnguljen e shqiptarëve në Sllavoni dhe ipeshkvin Mikel Summa duhet shfletuar shkrimet e Frok Zefit (Frok Zefiq).

Peter Bartl dhe botimi italisht i relacionit të Zmajević

Peter Bartl (1938-2022) ishte njohës shumë i mirë i historisë shqiptare, tërë jetën ia kushtoi historisë shqiptare. Veprat që kanë lënë mbresa në historinë dhe historiografinë shqiptare janë sidomos publikimi i dokumenteve nga arkivi i Propaganda Fide i Vatikanit, ato të Zmajević, dhe Vepra në 5 vëllime me titullin “Albania Sacra” që përmban dokumente të dioqezave shqiptare: 1. Ipeshkvia e Lezhës (2007), 2. Ipeshkvia e Durrësit (2011), 3. Ipeshkvia e Sapës (2014), 4. Ipeshkvia e Pultit (2017) dhe 5. Ipeshkvia e Shkodrës (2021). Bartl e kam njohur qysh prej 1996.

Bartl ka botuar dy vepra më titull: “Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte im 17. Und 18. Jahrhundert” I dhe II. Vepra I është botuar tek shtëpia botuese Harrassowitz (Wiesbaden) më 1975 dhe vepra II është botuar tek shtëpia botuese Trofenik (München) më 1979. Që të dyja kanë të bëjnë vetëm me Vincenc Zmajević-in. Vepra e parë ka të bëjë me jetën, biografinë e Zmajević, dhe një pjesë të madhe të letrave të tij apo personave që kanë të bëjnë me të, të dërguara në atë kohë. Veprën II ia kushton Giuseppe Valentini-t me këto fjalë: “Josepho Valentini/Rerum Albanicarum/Indagatori Egregio”, libër në të cilin është botuar relacioni i Zmajević i vitit 1702/03, fq. 1-186 me disa letra të tjera të tij.

Me angazhimin tim, u realizua përkthimi/botimi i tij dhe u botua vepra e tij më 1999 „Shqipëria nga mesjeta deri sot“, përkthyer nga Shkumbin Brestovci, që e botoi Ipeshkvia e Prizrenit, nën përkujdesjen dhe përkrahjen e ipeshkvit të Prizrenit Mark Sopi. Pastaj përkthyem disa shkrime të ndryshme që u botuan në revistën “Urtia” duke vazhduar deri tani. Së fundi, kemi një libër me 17 artikuj të Peter Bartl të përkthyer shqip, që do të botohet së shpejti me këta artikuj në shqip. Kur u botua

libri i Bartl, më 1999, mendoja atëherë se ky ishte përkthimi në shqip i pari, por më vonë mësova se Zamputti kishte përkthyer më herët nga vepra të Bartl pikërisht relacionin e Zmajević, por që nuk ishte botuar deri më tani. Në një intervistë të gjatë që kam bërë me Bartl, më 06.12.2015 në shtëpinë e tij në Pullach/München, e cila është ende e papublikuar, e kam pyetur Bartl se a dinte për përkthimin e këtij relacioni në gjuhën shqipe dhe ai më tha se nuk dinte asgjë për përkthimin e Injac Zamputti-t.

Përkthimi shqip i relacionit të Zmajević nga Injac Zamputti

Injac Zamputti (1910-1998) është njëri ndër historianët më të rëndësishëm për historinë e mesjetës shqiptare. Vendlindja e tij ishte Shkodra, me të cilin qytet ishte i lidhur shumë. Zamputti kishte babanë italian, kurse nënën shqiptare. Albanisches Institut dhe Shtëpia Botuese "Faik Konica" kanë botuar deri më sot disa vepra të Injac Zamputti-t. Arsyeja e botimeve të veprave të Zamputti-t është respekti që kemi për punën e tij. Plotësisht jemi të vetëdijshëm se kjo do të vlerësohet më vonë nga historianët e vërtetë dhe institucionet përkatëse. Nuk është dëshirë e jona që vepra e Zamputti-t të shkallmohet apo edhe degradohet nga psoudohistorianët, këtë ia lëmë kohës ta gjykojë. Vepra e tij është pa dyshim themeli dhe shtylla kryesore e historiografisë shqiptare. Zamputti kishte kuptuar rëndësinë e dokumenteve dhe e kishte marrë përsipër këtë si një mision që të sillte në shqip dokumentet më të rëndësishme për historinë shqiptare. Në fakt, ai ishte pothuajse i vetmi që e kuptoi si askush tjetër se njohja e burimeve është mundësia më e mirë për të studiuar si duhet historinë e një vendi dhe përmes kësaj nisme ai synoi të krijonte breza të rinj historianësh të mirëfilltë. Modeli i transkriptimit, përkthimit dhe botimit të dokumenteve në gjuhën shqipe dhe origjinale (italiane e latine), ka mbetur sot e kësaj dite ende i "vetmuar". Në Universitetin e Triestes të Italisë, Zamputti kishte mbrojtur tezën me titull: "Il Settecento Veneziano e l'albania Turca" (Ignazio Zamputti) më 1941. Ky titull doktorate (laure) në Shqipëri nuk i është njohur kurrë Zamputti-t. Për të parën herë është publikuar kjo tezë për publikun nga Albanisches Institut & Faik Konica, më 2020 bashkë me shumë studime e artikuj të tjerë të Zamputti-t në vëllimin me titull "Studime Albanologjike (1941-2013). Në këtë tezë doktorate (laure) Zamputti trajton, në disa vende, punën dhe veprën e Zmajević, Kuvendin e Arbrit dhe punën e tij për Arbanasit e Zarës (Kroaci). Pra, për Zamputti-n vepra e Zmajević ishte e njohur. Zamputti e dinte vlerën e Zmajević dhe kjo është arsyeja që përktheu në gjuhën shqipe këtë relacion. Relacioni i përkthyer nga Zamputti ruhet në fondin personal të

Drejtorisë së Përgjithshme e Arkivave, Arkivi Qendror Shtetëror, Fondet Personale, Fo 846 Injac Zamputi, V. Material i grumbulluar, D. 104, 105 dhe 106. Në këtë libër kemi disa faksimile nga dorëshkrimet e tij. Ka edhe ndonjë kopje tjetër të përkthimit, p. sh. një ruhet tek arkivi i Institutit të Historisë në Tiranë. Duhet cekur se përkthimi që ruhet në Arkivin Shtetëror ka dy versione, me dorë shkruar nga Zamputti dhe me makinë të shtypur po nga ai vetë.

Arsyen e mosbtimit të këtij përkthimi nga institucionet përkatëse nuk e kam kuptuar kurrë, edhe pse në jo pak raste përmendet apo citohet ky përkthim.

Trekëndëshi historik Valentini/Bartl/Zamputti

Është një trekëndësh interesant i dijetarëve Valentini/Bartl/Zamputti. Valentini ishte mësuesi i Zamputti-t. Lufta II botërore i ndan ata. Giuseppe Valentini jetoi dhe veproi deri para luftës në Shqipëri, kurse pas saj në Itali. Zamputti në Shqipëri. Bartl njohu Valentini-n në arkivin e Vatikanit (sipas intervistës së tij më 2015 të pabotuar) dhe veprën ku publikoi relacionin e Zmajević ia kushton Valentini-t. Këta tre dijetarë kanë një gjë të përbashkët, “Sanctum documentum”, dokumentet për ta ishin të shenjta. Këta ishin të vetëdijshëm se, më së miri, historia shqiptare shkruhet përmes publikimit të dokumenteve. Nëse shikohet publikimi i dokumenteve të përgatitur nga këta tre studiues dhe kur analizohet periudha me shekuj vërehet një gjë me rëndësi. Valentini kishte një periudhë të historisë, sidomos të mesjetës së mesme dhe të vonshme. Gati aty ku përfundon Valentini, fillon Zamputti, gati aty ku përfundon Zamputti fillon Bartl. Vetëm se tek Zamputti është një tragjedi më vete, që nuk arriti t’i prekte me dorë ato dokumente relike, që Valentini e Bartl e bënë, sepse sistemi në të cilën jetonte Zamputti nuk ia lejonte. Ironia e madhe është që sistemi komunist e detyroi Zamputti-n të shkruan një libër në vete për “gabimet” e Valentini-t (libri është në dorëshkrim ende i pabotuar). Por, mos të harrohet një gjë, se Zamputti ishte i vetmi që i botoi në dy gjuhë, italisht e shqip, pra ato edhe i përktheu në shqip. Po mos të ishin këta tre dijetarë, nuk di se në çfarë gjendje kaotike dhe rrëmuje do të ishte historiografia shqiptare sot.

Rreth botimit të këtij libri

Titulli i këtij libri është: “Vincenzo Zmajevich, Relacion i gjendjes së Shqipërisë e Serbisë/ Relazione dello stato d’Albania e Serbia (1702-1703).” I ngjashëm është edhe titulli i relacionit që ruhet në Archivio de Propaganda Fide në Vatikan (krahaso faksimilin e kësaj faqeje në këtë

libër). Libri është i ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë është relacioni i Zmajević në dy gjuhë, italisht (originali) dhe shqip, në italisht e ka botuar Bartl dhe përkthimi i Zamputti-t nga libri i Bartl. Referencat te përkthimi janë të Zamputti-t ndërsa ato te dokumenti në italisht i riprodhuar këtu, janë të Bartl të përkthyer nga Zef Noka. Pjesa e dytë është shtojcë mbi jetën dhe veprimtarinë e Zmajević me tri shkrime. Relacioni i Zmajević ka të shënuar anash disa shënime të shkurtra, për përmbajtjen e tekstit në ato pjesë. Këto i ka botuar Bartl në librin e tij. Zamputti nuk i ka përkthyer këta rreshta, e për këtë arsye, nuk i sollëm edhe këtu. Në fund, kemi pjesën e dytë, si shtojcë të këtij libri me testamentin e Vincenc Zmajević që na e ka siguruar Lovorka Čoralić dhe dy artikuj të tjerë: njëri i Peter Bartl dhe tjetri i Frok Zefit, që kanë të bëjnë me jetën dhe veprimtarinë e Vincenc Zmajević.

Pasi që përkthimi i relacionit të Zmajević është marrë nga libri i Bartl, Albanisches Institut siguroi të drejtat e botimit dhe përkthimit edhe nga Bartl, kurse nga familja e Zamputti-t i kishim edhe më herët.

Pjesërisht shpenzimet e këtij botimi i mbuloi autori i këtyre rreshtave, si respekt për punën dhe veprën e Injac Zamputti dhe Peter Bartl.

Këtë botim e bëjmë së bashku *Albanisches Institut* në St. Gallen me Shtëpinë Botuese *Faik Konica* në Prishtinë për të cilën e falënderojmë Nazmi dhe Arbër Rrahmanin për përkrahjen e tyre. Një falënderim të veçantë duhet shprehur për Zef Nokën për desing e përgatitjen teknike të librit dhe Jozef Zamputtin për përgatitje në word të relacionit italisht e shqip.

Ky botim i këtij libri ishte një udhëtim i gjatë dhe me disa peripeci, por gjithsesi është pak për mburrje, pasi ia dolëm ta botojmë në këtë mënyrë.

Albert Ramaj, Zürich 2022

Njoftime të gjithëanshme mbi gjendjen e Shqipërisë dhe veprimtarisë së imzot Vincent Zmajeviqit kryepeshkop i Tivarit vizitator apostolik i Shqipërisë

Shqyrtuar në mbledhjet e përgjithshme të Prop. Fide të 3 dhe 18 dhjetorit 1703, 7, 21 dhe 28 janarit dhe 12 shkurtit 1704.

Siç shihet në fletën e Vendimeve të vendosur në fund dhe shënuar me shkronjën A.

Krenohet Shqipëria se zanafillën e ka nga princa fisnikë, duke e nxjerrë nga Albanët italianë. Këta ndjekësa të Herkullit, kur ai u kthye nga Italia – siç thotë Trogo Pompei – banuan për një kohë të gjatë në afërsitë e Kolkidës ndërmjet detit Kaspik dhe kënetës Meotide¹ duke i fisnikëruar ato hapësira të vetmuara me emrin Albania². Të trazuar e të munduar prej luftërave të gjata me fqinjët tartarë, pasi e braktisën Azinë, u kthyen³ në Evropë ku, pasi zunë vend⁴ në pjesën më të bukur të Maqedonisë, ndërmjet qytetit të Durrësit dhe Apollonisë, i dhanë emrin Albania. Krahina, që aso kohe ishte përfshirë ndër kufij të ngushtë, me kalimin e kohës dhe me vlerën e armëve, u shtri ndërmjet lumit të Drinit dhe Himarës dhe Maleve Kamoli dhe Statei⁵. Më në fund, e pushtuar prej turqve bashkë me Maqedoninë fqinje dhe Epirin, ashtu edhe me një pjesë të mirë të Dalmatisë aty pranë, [Shqipëria] tani përfshin të gjithë atë pjesë të vendit bregdetar që ndodhet ndërmjet Pastrovitit⁶, kufirit të fundit të Republikës Venedike, dhe Gjirit të Ambrakjes, i quajtur Liqeni i

¹ Maeotis palus - Deti Azov

² Nje nga tezat që qarkulluan për prejardhjen e shqiptarëve ishte kjo se kishin ardhur prej Kaukazit. Relatori V. Zmajeviq, meqenëse qysh më 1700 ishte emëruar papë i Romës Klementi XI, i cili ishte nga familja Albani, familje shqiptare në mërgim, e bën këtë shtëpi aq të lashtë sa edhe legjenda e Herkullit dhe shqiptarët aktualë i bën të rrjedhur nga Kaukazi. Tezë kjo që, ashtu si të tjerat që qarkullonin, nuk ka asnjë vërtetësi. Me të vërtetë, historiani romak, Taciti, flet për një traditë kaukazike, por me rrjedhime të kundërta nga ato të tezave mesjetare për prejardhjen e shqiptarëve. Kur romakët pushtuan ato vise të Kaukazit, tregon historiani, gjetën aty legjendën se Albanët vinin nga Ballkani. Rrjedhimi i këtij lajmi do të ishte pra se Albanët apo Arbërit ishin autokotonë në Ballkan dhe se një pjesë syresh ishin shpërngulur në Kaukaz. Kjo është e mundur sepse shpërngulje shqiptarësh ka pasur gjatë historisë, por pa u boshatisur toka-mëmë. (Shih: Tacito, Annali XXXIV – traduzione italiana Bernardo Davanzati, Salani, Firenze 1937, fq. 265).

³ Botimi ka fjalën *ritirarono* pa pjesëzën *si*. Ne mendojmë se është një gabim në vend të fjalës *ritornarono*.

⁴ Originali ka fjalën *occupata* që ne i japim vlerën *zunë vend*, dhe jo me vështrim pushtimi.

⁵ Botuesi, ndër të tjera, për identifikimin e këtyre maleve, sjell edhe këtë copë nga Gjeografia e Pirro Ligorio (Romë 1561): "Shqipëria nga Veriu ka lumin e Drinit dhe malin Çikaro (Cicaro), nga Jugu lumin Polindo që lag Vlorën, nga Lindja malet Kamuli dhe Satrei kurse nga Perëndimi qytetin e Durrësit". (Almagià, *Le più antiche rappresentazioni cartografiche*).

⁶ Në Mal të Zi me kryevend Buduen në V të Tivarit

Artës. Dhe quhen me emrin Shqipëri jo vetëm qytetet Tivari dhe Ulqini që i përkasin Dalmatisë, por edhe i gjithë Epiri që shtrihet qysh nga Vlora deri te po ai Liqeni i Artës dhe pjesa më e madhe e Maqedonisë. Kështu turqit, duke admiruar guximin e lashtë shqiptar, edhe pse ka qenë fatal për kombin e tyre, të thuash si çmim të trimërisë që nderohet edhe prej armikut, ua hoqën krahinave të tjera meritimet për ta bërë më të fuqishme atë Krahinë (shqiptare), me një zmadhim të ri, që dikur u tall me forcat fitimtare të turqve, dhe sot ia rrit madhësitë barbare lavdinë se ka nënshtruar kombin më luftarak⁷.

Në këtë vendosje, Shqipëria shtrihet nëpër bregun detar të lagur prej detit Adriatik dhe Jonit, me një gjatësi prej dyqind e pesëdhjetë milje dhe me gjerësi, me përpjesëtim jo të barabartë, rreth njëqind milje. Nga Lindja ka në kufi Maqedoninë dhe Akenë, nga Jugu Adriatikon e Jonin, nga Perëndimi Dalmatinë dhe Hercegovinën dhe nga Veriu Serbinë⁸.

Vendi është shumë i begatë dhe pjellor aty ku del në fushë, i lagur prej lumenjsh e liqenesh plot me peshk, i ujitur me ujëra të shpeshta në një klimë të butë. Ka fusha të këndshme, por malet shumë të larta janë shterpë në shumicë e të begatura vetëm me kullotje në stinë të verës. Prodhon pyje me drurë madhësie të pamasë, të aftë për të ndërtuar flota të tëra, miniera me pisë të shumtë, vajëra dhe drithë me një sasi të tillë saqë nozullon me shumicë krahinat fqinje ashtu edhe ato që janë më larg. U jep kalim⁹ mallrave të pasura si: mëndafsh, dyll, lesh, lëkurë dhe të tilla të ngjashme që, nga Vllahia, Moldavia, Rumania, Bullgaria, Serbia dhe Maqedonia, sillen me sasi të mëdha në Durrës, Shkodër e Sajadhë¹⁰ prej nga, me anije venedike, sillen në Venedik dhe një pjesë në Ankonë.

Nuk është kudo e banuar prej katolikësh, meqë ajo pjesë e gjatë e vendit që është, në pjesën më të madhe, fushë dhe më pjellore dhe që shtrihet nga qyteti i Durrësit deri te Liqeni i Artës, e gjatë njëqind e pesëdhjetë milje, është e gjitha e banuar prej myslimanësh e grekë-skizmatikësh¹¹, kurse vetëm në Himarë, që është kaq e famshme me malet Akroceraune për të cilat kanë kënduar poetët, janë katolikë të rritit grek.

⁷ Në këtë sintezë të situatës së kohës turke disa të vërteta të trimërisë dhe të shtrirjes së shqiptarëve ngatërrohen me tezat shoviniste të atyre që synonin, qysh në atë fillim shekulli, të përvetësonin vende e popullsi në shtetet e tyre të ardhshme.

⁸ Të tilla orientime takohen edhe në botime të mëparshme dhe duhen marrë për aq sa vlenin për njohuritë e kohës.

⁹ U jep kalim – e lamë siç e ka origjinali. Dihet se konfiguracioni gjeografik i bregdetit lindor të Adriatikut vetëm në Shqipëri, me luginat kryesore të Drinit, Shkumbinit e Vjosës, lejon rrugët natyrore për t'u lidhur me brendinë e Ballkanit dhe anasjelltas.

¹⁰ Botuesi vë me pikëpyetje se mos është Shëngjini, por ne kemi bindjen se flitet për Sajadhën bregdetare në afërsi të Korfuzit.

¹¹ Kuptohet: ortodoksë të rritit grek, po sikundër më poshtë, te Himara, thotë: katolikë të rritit grek.

Prandaj Shqipëria e banuar prej katolikësh të rritit roman përfshin vetëm dioqezat e Tivarit, Shkodrës, Pultit, Sapës, Lezhës e Durrësit. [Kjo Shqipëri], duke formuar një vijë gjysëm rrethore jo të përsosur, shtrihet me një gjatësi njëqind miljesh në anën prej detit dhe rreth po aq [milje] në gjerësi.

Me të gjitha këto begati që fal kjo krahinë, banorët e krishterë do të gëzonin çdo lumturi njerëzore në këtë tokë pjellore sikur të mos ishin të trazuar prej mundimeve të vazhdueshme që u shkaktojnë turqit. Këta, duke i zhveshur shpesh e shpesh, herë pjesërisht herë terësisht prej pasurive të tyre, me pretekste të ngjashme me ato të ujkut me dhinë¹² ua heqin edhe të gjithë dashurinë për kultivimin e tokave – që janë i vetmi mjet jetese për ta – dhe prandaj të krishterët shumicën e mbajnë të pakultivuar, ose së paku pa asnjë përpjekje të frytshme, që kështu të tregojnë në të gjitha mënyrët varfërinë e vet më të madhe, me qëllim që të shpëtojnë veten e tyre.

Në asnjë krahinë të Turqisë nuk janë të shtypur kaq shumë besimtarët dhe nuk janë kaq të egër turqit ndaj tyre sesa në Shqipëri, dhe ky trajtim çnjerëzor i të pafeve lind nga një egërsi e veçantë e tyre, nga urrejtja më e madhe e pamëshirshme që ata ushqejnë ndaj emrit të krishterë si gjinde kufitare e stërvitur në rast luftërash, në përleshje të përgjakshme, në rrënime reciproke me të krishterët fqinj dhe së fundi [lind ky trajtim] nga frika e vazhdueshme e shkaktuar prej trimërisë që besnikët e kombit [shqiptar] kanë treguar në shumë përballime me shumë dëm për vetë të pafetë.

Kundër këtij gjarpri që vazhdimisht ia bren zemrën, turqit nuk gjejnë ilaç më të mirë sesa atë që t'i mbajnë të shtypur të krishterët, duke prerë me shpejtësi të gjitha lulëkuqet që mund t'u bëjnë hije bimëve të tjera. Këndeji lind gjendja e mjerë e besimtarëve që kanë rënë kaq poshtë saqë pothuaj që të gjithë, me përjashtim të shumë pak vetave – dhe këta të mbrojtur prej sunduesve me autoritet – jetojnë me punën e mundimshme të djersës së tyre në fshat për të nxjerrë vetëm aq sa mund të mjaftojë për jetesën e vet.

Të gjitha këto të zeza të përditshme dhe të përgjithshme të kombit nuk e kishin zhburrëruar shpirtin e popujve malorë të Shqipërisë, që janë të palodhur në ushtrimin (përdorimin) e armëve sepse, në kohë të kaluar, dhe veçanërisht në kohë të luftërave ndërmjet turqve dhe princave të krishterë, me pretimet e tyre të vazhdueshme në viset më të thella të Turqisë, dhe kudo, duke çuditur për guximin që e

¹² Me të vërtetë fabula e njohur flet për qingjin që po pinte ujë në rrjedhën poshtë vendit ku po pinte edhe ujku i cili, pas arsyeve të shëndosha që i sillte qingji se nuk kishte si t'ia turbullonte ujin meqë ishte poshtë tij, s'gjeti tjetër pretekst për ta shqyer veçse duke i thënë se ujin ia kishin turbulluar dikur pararendësit e qingjit.

Raporti i Zmajevich-it në italisht – *Peter Bartl*¹³²

NOTITIE UNIVERSALI DELLO STATO DI ALBANIA, E DELL'OPERATO DA MONSIG.R VINCENZO ZMAIEVICH ARCIVESCOVO DI ANTIVARI VISITATORE APOSTOLICO DELL'ALBANIA

*Esaminate nelle Congregationi Generali di Prop.a Fide de 3., e 18. Xm.bre
1703, 7., 21., e 28. Gennaro e 12. Febraro 1704. Si come si uede dal foglio
delle Risolutioni posto in fine segnato L.ra A.*

Vanta l'Albania la sua origine da nobili principij, deriuandola da gl'Albani Italiani; questi seguaci d'Ercole nel suo ritorno d'Italia (al sentire di Trogo Pompeo) habitorno lungam.te nelle vicinanze della Colchide trà il Mare Caspico, e la Palude Meotide¹³³, nobilitando quelle vaste solitudini col nome di Albania. Trauagliati da lunghe continue guerre con li tartari vicini, abbandonata l'Asia, ritirarono nell' Europa, et occupata la più bella parte della Macedonia tra la città di Durazzo, et Appollonia, li diedero il nome d'Albania¹³⁴, Prouincia, che all' hora ristretta da angusti confini nel progresso di tempo con ualor dell'armi s'estese trà il fiume Drino e Zimarra¹³⁵, et i Monti Camoli¹³⁶ e Statei¹³⁷, e finalm.te soggiogata da Turchi colla confinante Macedonia, et Epiro, e buona parte della contigua Dalmazia, abbraccia hora tutto quel tratto de paese maritimo, che è tra Pastrouichi¹³⁸, ultimo confine della Repub.ca Veneta, et il Golfo Ambrac-

¹³² Fusnotat janë të Peter Bartl.

¹³³ Meotis palus = Azovches Meerm, deti azovik.

¹³⁴ Zmajević i lidh Albanët e Kaukazit me popullin ballkanik me të njëjtin emër. Sipas Trogus Pompeius, vepra historike e të cilit njihet kryesisht nga fragmentet e Justinit, shqiptarët e Kaukazit ishin me origjinë italice.

Teza e origjinës kaukaziane të shqiptarëve të Ballkanit u përfaqësua nga disa autorë edhe në shekullin e kaluar, së fundmi nga Francesco T a j a n i, *Le istorie albanesi*. 1. Salerno 1886, veçanërisht fq. I. – XXXIV.

Për shqiptarët e Kaukazit që nuk kanë asgjë të përbashkët me ata të Ballkanit përveç emrit, shih Voprosy istorii Kavkazskoj Albanii. Sbornik statej. Baku 1962; Kamilla Vasil'evna T r e v e r e. Očerki po istorii i kul'ture Kavkazskoj Albanii 14, v. do n.e. – 7 v. n.e. Moskva. Leningrad 1959; Movses D a s x u r a n c i, *The History of the Caucasian Albanians*. London 1962.

¹³⁵ Himara, rrethi bregdetar malor në jug të Vlorës.

¹³⁶ Në hartat Ptolemeike (botimi romak 1490) gjendet një varg malor "Camulii montes" në jugperëndim të Ohrit, shih f. 2 bei Roberto A l m a g i à, *Le più antiche rappresentazioni cartografiche della regione albanese*, në: *Bollettino della Reale Società Geografica* 48 (1914) fq. 607.

¹³⁷ I njëjti me "Satrei monti"? shih legjendën për hartën e Greqisë nga Pirro Ligorio (Rom 1561): "L'Albania ha da Tramontana il fiume Ludrino ed il monte Cicaro, da mezzo giorno Polindo fiume, che bagna la Valona, da Leuante Camuli et S a t r e i monti et da Ponente la città di Durazzo." (citar sipas A l m a g i à, *Le più antiche rappresentazioni geografiche*. fq.613.)

¹³⁸ Paštrovići = Zona malore në jug të Budvës me qytetin kryesor Petrovac.

cio¹³⁹, detto lago di Larta, passando sotto nome d'Albania non solo le città d'Antiuari, e Dolcigno pertinenti alla Dalmazia, mà in oltre tutto l'Epiro, esteso dalla Valona sino allo stesso lago di Larta, e la maggior parte della Macedonia. Così li Turchi ammirando l'antico coraggio Albanese, benché fatale alla loro nazione, quasi in premio della uirtù, che uenera anche nell'inimico, tolsero ad altre prouincie li peggri, per render più cospicua con nuouo ingrandimento quella Prouincia, che una uolta derise le uittoriose forze de Turchi, et hora accresce al barbaro fasto la gloria d'hauer soggiogata la più bellicosa nazione.

Con tal positura s'estende l'Albania in lunghezza per la costa maritima, bagnata dal mare Adriatico, et Ionio miglia doicento e cinquanta, et in larghezza con disugual proportione miglia cento incirca. Confina dall'Oriente con la Macedonia, et Achaia, dal mezzo di coll'Adriatico, e Ionio, dall'Occidente con la Dalmazia et Erzegouina, e dalla parte Boreale colla Seruia.

Il paese è molto abbondante, e fertile, doue si piega nel piano, bagnato da fiumi, e laghi copiosi di pescaggione, irrigato da acque frequenti sotto clima temperato. Hà pianure amene, mà li monti altissimi, la maggior parte sterili, fertili solo di pascoli nel tempo dell'estate. Produce boschi d'arbori smisurati nella grandezza, atti per la fabrica d'armate intiere, miniere di pece abbondantissima, ogli e grani in quantità tale, che prouede sufficientem.te alla consistenza delle confinanti prouincie, et anche delle più lontani. Somministra il passo alle ricche merci di seta, cere, lane, cordouano e simili che dalla Valachia, Moldauia, Romania, Bulgaria, e Macedonia confluiscono abbondan- tem. te à Durazzo, Scuttari, e Saiada¹⁴⁰, e caricate sopra vascelli christiani sono trasportate in Venezia, e qualche parte in Ancona.

Non è da per tutto habitata da Cattolici, poiche quel lungo tratto di paese la maggior parte piano, e piu fruttifero, che giace tra la città di Durazzo, et il lago di Larta, lungo cento, e cinquanta miglia, tutto è habitato da Turchi, e Greci Scismatici, e solamente nella Zimara tanto famosa per li Monti Ceraunij, celebrati dalli poeti, sono Cattolici di rito greco. Adunque l'Albania habitata da Cattolici di rito Romano abbraccia le sole Diocesi d'Antiuari, Scuttari, Pulati, Sappa, Alessio, e Durazzo, e formando la linea semicircolare imperfetta, s'estende in lunghezza per la parte di mare miglia cento, et altrettanti incirca di larghezza.

Trà tanti commodi, che dona la Prouincia goderebbero gli abitanti Christiani ogn'umana felicità nell' ubertoso terreno, quando non fossero molestati dalle continue tribulazioni de Turchi, che spogliandoli

¹³⁹ Gjiri i Ambrakisë, sot Arta.

¹⁴⁰ emri nuk mund të konstatohet. San Giovanni di Medua?

frequentem.te hor in parte, hor in tutto delle loro facultà sotto pretesti uniformi à quelli del lupo con la capra, gli leuano anche tutto l'amore uerso la coltura delle terre, (loro unica consistenza) tenute per ciò da Christiani la maggior parte ò incolte, ò almeno senza uerun fruttuoso artificio per affettare in tutte le apparenze estrema pouertà in riguardo dell' indennità propria.

In ueruna Prou.a della Turchia non sono tanto oppressi li fedeli, ne più fieri li Turchi verso di quelli, quanto in Albania, nascendo tale inhumano trattam.to degl'infedeli da certa particolar fierezza de med.mi, dal maggior odio implacabile, che nutrono uerso il nome Christiano, come gente di confine, auezza in occasione di guerre à sanguinosi cimenti, à stragi reciproche con Christiani confinanti, e finalm.te da continue gelosie causate dal prouato valore in più incontri da fedeli nazionali con tanto danno degl'infedeli stessi.

Contro questa vipera, che gli rode continuam.te il cuore, non trouano li Turchi miglior antidoto quanto quello di tener bassi li Christiani, recidendo sollicitam.te tutti le Papaueri, che possono far ombra ad altre herbe. Di qua nasce la misera condizione de fedeli, costituiti in stato così infelice, che quasi tutti, eccettuati pochissimi, e questi protetti dell'autoreuoli commandanti, uiuono colle stentate industrie de proprij sudori nel lauoro della campagna per ritrahere sol tanto, quanto li può bastare per la propria sussistenza.

Tutte queste diuturne calamità communi alla Nazione non haueano auilito l'animo delli Popoli Montani d'Albania infaticabili nell'esercizio dell' armi, perché nelli tempi passati, e particolarmente delle guerre trà li Turchi e P(ri)n(ci)pi Christiani resi formidabili al gouerno colle continue scorrerie nelle parti più interne della Turchia, portauano da per tutto un uniuersal stupore, e coraggio super.re alle forze, e straggi, e desolat.ni. Successa all'ultima guerra la pace, diede motiui alli Turchi di premunirsi contro tali intestine commot.ni, acciò in occasione delle future guerre con P(ri)n(ci)pi confinanti restassero esenti di quelle punture, che ben spesso li hanno apportato, e trepidat.ne, e dolore.

Aualorato dalli premurosi comandi della Porta, e stimolato dalla propria passione di vendicare li sensibili danni riceuuti nel saccheggio, e deuastat.ne della propia casa, e Patria dalli Montagnuoli, accorse per domargli, trè anni sono Odda Verdi Bassa Mahmutbegouich, e più col fatal incontro delle ciuili discordie trà Christiani stessi, che col ualore de proprij soldati superò coloro, che sin'allora s'erano resi insuperabili alle maggiori forze de Turchi, sforzando li più potenti à mutar paese, interinandoli nelle viscere della Turchia raffrenando l'altri coll'ereit.ne di fortezze, et opprimendoli colle grauezze intollerabili de tributi, resi comuni à tutti gl'altri Christiani delle pianure.

Shtojca

Lovorka Čoralić

Testamenti i ipeshkvit Vinzenc Zmajević²²⁶

(Znanstvena knjižnica Zadar, Ms. 1008, inv. br. 163847, str. 1-20)

Ad majorem Dei gloriam

Illumina Oculos meos, ne uncquam abdormiam in Morte

Psalmò N 12

Perchè la morte sia principio di vita, ricerca dall'uomo Cristiano, e prudente quelle preve disposizioni, che sono relative alli documenti Evangelici, onde tra la certezza del colpo, è l'incertezza del tempo non venghi sorpreso dall'ultime angustie senza aver ubbidito alle voci del Cielo, dispone domui tue quia morieris. Li giornalieri esempi sono gran lezione, che è insegna quanto siia all'uomo opportuno, e prezioso, per non perderlo fra tardi consigli, et inportune dilazioni, quel tempo di cui è sola dispositrice la Provvidenza eterna, che maneggia e qualmente a suo arbitrio e la nostra vita, e la nostra morte.

Con questi doverasi riflessi davendo io Vincenzo Zmajevich, Arcivescovo di Zara dispone delle cose mie, per star sempre pronto al gran passaggio del tempo all'eternità, e per non lasciarmi vincere dalle lusinghe della salute perfetta, che m'assiste coll' anima sempre centrata, e prostrata al Trono delle Divine Misericordie invoco l'intercessione della gran Madre di Dio, mia benefica Protettrice perchè si degni impietrare agl'occhi miei quei lumi, per i quali umquam abdormianti in morte anzi siano scorta sicura alla mia mano per condurre al buon fine l'impegno presente dell'anima mia.

Rinuocco ora et intendo rinuorare ogni momento sino all'ultimo respiro di mia vita, le proteste di credere tutto ciò che crede la Santa Madre Chiesa, Cattolica Romana, pronto sempre da spargere tutto il sangue mio per la verità delli suoi Dogmi Santissimi, e per la difesa di quella Fede, che chiude il prezzo del sangue di Cristo; et è il più ricco Capitale della nostra Redenzione.

Benche siano gravissime le colpe mie, e si facciano autrici del giusto timare ch'ingombra l'anima mia peccatrice per dover comparire servo inutile al tremendo Tribunale di Dio, e render conto al gran

²²⁶ Nga libri i Lovorka Čoralić, Odabrane teme iz povijesti albansko-hvatskih veza (shqip: *Tema të zgjedhura nga historia e marrëdhënieve shqiptaro-kroate*) (Albanisches Institut, St. Gallen & Hrvatski Institut za povijest, Zagreb 2022).

Peter Bartl

Kryeipeshkevi Vinzenz Zmajeviq dhe thirrja e Kuvendi Arbënit më 1703²³⁷

Vinzenz Zmajeviq, Kryeipeshkëv i Tivarit (1701-1713) dhe Zarit (Zadar) (1713-1745), është një ndër politikanët më të rëndësishëm të Kishës Katolike në Europën Juglindore të asaj kohe. Biografi i tij i parë Antonio Bassich nga Kotorri, e cilëson atë si *“uno de’ più celebri, a’ quali la Dalmazia abbia dato i natali”*²³⁸. Historiani kishtar nga Kroacia, Pavao Butorac, e cilëson Zmajeviq jo vetëm si një ndër bijtë më të mëdhenj të vendlindjes së tij Perast dhe si njeriun më me zë që ka nxjerrë Boka Kotorska, por e rradhit atë ndër paraardhësit e drejtpërdrejtë të Ipeshkëvit Strossmayer.²³⁹ Kështu, ai e lidh Vinzenz Zmajeviq me njeriun i cili u përpoq të arrinte jo vetëm bashkimin kishtar, por edhe bashkimin politik të të gjithë sllavëve jugorë. Si Kryeipeshkëv i Zarës (Zadar), Zmajeviq, u angazhua për mbajtjen e Glagolicës, për ruajtjen e gjuhës së vjetër sllave kishtare ndër katolikë, si dhe mundësoi, me shpenzimet e veta, ndërtimin e një *“Seminario illirico”* në Zarë (Zadar), për arsimimin e brezit të ri të priftërinjve që flisnin kroatisht. Ai nxiti misionin katolik në Bullgari dhe mbajti lidhje të ngushta me Rusinë, ku vëllai i tij, Matija, shërbente si Admiral i Flotës Balltike. Këtij të fundit, Zmajeviq i dërgoi si meshtar kapelan, klerikun nga Spliti, Matija Karaman, i cili, më vonë, do të jepte mësimin e gjuhës së vjetër kishtare sllave në Romë, e më 1704 do të botonte një meshar në glagolisht dhe së fundi do të bëhej pasardhësi i vetë Zmajeviq. Nga kontaktet e tij me botën sllave, Zmajeviq ishte *“Nismëtari për bashkimin e sllavëve”*.²⁴⁰ Gjithsesi, ky ishte vetëm një ndër aspektet e rolit që ai ka luajtur. Gjatë periudhës kur ishte Kryeipeshkëv i Tivarit, Shqipërinë e kishte në plan të parë, duke e cilësuar atë si kombin e tij të preferuar *“natione prediletta”*²⁴¹, dhe me

²³⁷ Përktheu nga gjermanishtja Blerina Meçule. Marrë nga Peter Bartl “Kryeipeshkvi Vinçenc Zmajeviqi dhe thirrja e Konçilit të parë kombëtar shqiptar (Kuvendi i Arbënit)”: *300-vjetori i Kuvendit të Arbnit, Simpozium, Tiranë, 24-25 tetor 2004*, Konferenca Ipeshkvonre e Shqipërisë, (Shkodër: Arqipeshkvia Shkodër-Pult, 2009), S. 79-91.

²³⁸ Antonio Bassich, *Notizie della vita degli scritti di tre illustri Perastini*. Ragusa 1833. f. 2.

²³⁹ Pavao Butorac, *Vicko Zmajević (1670-1745)*. In: Ders., *Zmajević (Ogledi)*. Zagreb 1928. f. 33.

²⁴⁰ Kruno Krstić in *Enciklopedija Jugoslavije*. 8. Zagreb 1971. f. 628.

²⁴¹ Zmajeviq *Propagandës Fide*, Budva 28. 6. 1704 = *Archivio della S. Congregazione de Propaganda Fide* (fortan APF), *Scritture riferite nei Congressi* (Albania) 5, f. 771.

shqiptarët ruajti lidhje të ngushta edhe kur ishte Kryeipeshkëv i Zadarit²⁴².

Kështu në vitin 1726 ndihmoi emigrantët shqiptarë të ardhur në Zadar që të mund të nguliteshin aty. Kolonia shqiptare Borgo Erizzo (tani Arbanasit) ekziston ende sot.²⁴³

Vinzenz Zmajeviq lindi më 23 dhjetor 1670 në Perast, në gjirin e Kotorrit. I ati Krsto (Christoforo) ishte pronar anijesh dhe gjatë viteve 1671, 1679, 1680, qe kryetar i Bashkisë së Perast. Ai u dallua në luftën kundër piratëve ulqinakë dhe prandaj, në vitin 1675, nderohet me zinxhirin e artë për shërbimin që kreu.²⁴⁴

Me nxitjen e xhaxhait të tij Andrija Zmajeviq, Kryeipeshkëv i Tivarit në 1671-1694, Vinzenz Zmajeviq dërgohet në "*Collegium Urbanum*" të *Propaganda Fide* në Romë, ku përfundon studimet e larta për Teologji e Filozofi, si dhe shfaq prirjet letrare. Ai shkroi "*Corona poetica*", një përmbledhje me poezi në gjuhën latine, që u botua në Romë, më 1694, e titulluar "*Musarum chorus in laudem Antonii Zeni*".

Në vitin 1696 shugurohet meshtar²⁴⁵ dhe kthehet në atdhe, ku me propozimin e Bashkisë së Perastit emërohet nga Senati venedikas si abat i Sveti Djorde (Sveti Djorde në ishullin me të njëjtin emër që shtrihet para Perast). Ky emërim përfshinte edhe detyrën si famullitar i Perast. Në vitet 1699-1700 u përpoq më kot të botonte veprën kryesore të xhaxhait të tij Kronika Kishtare²⁴⁶, që ende, edhe sot, nuk është botuar. Projekti dështoi për shkak të vështirësive financiare²⁴⁷. Më 18 prill 1701, edhe pse ende nuk kishte mbushur 31 vjeç, ai emërohet nga Papa i sapozgjedhur Klementi i XI, si Kryeipeshkëv i Tivarit, Administrator i Dioçezës së Budvës dhe Vizitator Apostolik për Shqipërinë, Maqedoninë²⁴⁸, Serbinë, dhe Bullgarinë. Me lejen e Papës, rezidencën e

²⁴²Në lidhje më këte shih. Peter Bartl, Erzbischof Vinzenz Zmajević als "Visitor Apostolicus Albaniae". Në: Shejzat (Le Pleiadi) 16 (1972) f. 218-222.

²⁴³Për këtë shih Tullio Ereber, La colonia albanese di Borgo Erizzo presso Zara. Zara 1939; Aleksandar Stipčević, Kulturno povijesni spomenici u Arbanasima (Zadar). Povodom 250-godisnjice doseljenja zadarskih arbnasa. Zadar 1977; Kruno Krstić, Doseljenje arabanasa u Zadar. Zadar 1988.

²⁴⁴Pietro Ciuran, Provveditore Generale in Dalmazia et Albania, Zara 18. 7. 1675 = Naucna Biblioteka Zadar (Paravia) MS.24-38V61V LXXVIII/I/I, Nr.1, 2.

²⁴⁵Archivio Segreto Vaticano, Processi Datarie 78, f. 39 v.

²⁴⁶"Darxava sveta slavna i kreposna carkocnoga letopisa...", s. Jovan Radonić, Rimsa kurija i južno-slovenske zemlje od XVI do XIX veka. Beograd 1950. F. 359-361. Kronika gjendet në përmbledhje latine e sllave. Në lidhje me Dorëshkrimet shih. Ognjen Radulović, Ilustracije Zmajevićevog ljetopisa. In: Boka 19 (1987) f. 157-175.

²⁴⁷Zmajeviq i drejtohet Abatit Pastrito, Perast 20.5.1699 dhe Venedik 9.10. 1700, botuar nga Peter Bartl (Hrsg.), Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte im 17. und 18. Jahrhundert. I. Wiesbaden 1975. f. 29-30, 31-32.

²⁴⁸Nga ana territoriale jo e njëjtë me Maqedoninë e sotme, por përfshinte zonën midis Durrësit dhe Apollonisë (Pojani).

Frok Zefi

Vinko Zmajeviqi (1670-1745) dhe kryeipeshkvia e Shkupit³²⁰

Vinko Zmajeviqi lindi në Perast më 23 dhjetor 1670. I ati i tij Krsto disa herë ka qenë kapiten ose kryetar i qytetit. Me angazhimin e xhaxhait të tij, kryeipeshkvit të Tivarit, Andreut, Vinko studioi në kolegjin Urban në Romë, ku doktoroi në filozofi dhe teologji. Pas mbarimit të studimeve u kthye në vendlindje ku senati venedikas, me propozim të komunës së Perastit, sipas të drejtës së tij patronale, e emëroi abat të abacisë së Shën Gjergjit në ujdhesëzën me emër të njëjtë pranë Perastit (1695-1701). Me këtë emërim, ka qenë i bashkangjitur edhe shërbimi i famullitarit në Perast. Për shkak të erudicionit të tij, zhdërvjelltësisë dhe jetës shembullore priftërore, papa Klementi XI, më 18 prill 1701, e emëroi Vinkon për kryeipeshkëv të Tivarit, kur ky ishte vetëm 31 vjeç. Njëkohësisht, papa e emëroi edhe vizitator apostolik të Shqipërisë, Maqedonisë dhe Serbisë, dhe ia besoi administrimin e ipeshkvisë së Budvës. Shugurimin ipeshkvor e mori në kishën e shën Kollit të famullisë së Perastit, kurse e shuguroi ipeshkvi i Kotorrit Marin Drago. Papa me brevin apostolik e emëroi Vinko Zmajeviqin të deleguar apostolik të Kongregatës për përhapjen e fesë, për misionet në Shqipëri, Maqedoni dhe Serbi, e më pastaj edhe në Bullgari. Kryeipeshkvin Vinko Zmajeviq posaçërisht e respektonin papa Klementi XI, papa Inocenti XIII, papa Klementi XII dhe papa Benedikti XIV. Në Dalmaci, Shqipëri, Maqedoni, Serbi e më pastaj edhe në Bullgari, për ipeshkvij vendoseshin vetëm ata kandidatë të cilët i propozonte ai. Sipas propozimit të dogjit venedikas, papa Klementi XI, më 22 maj të vitit 1713, e emëroi Vinko Zmajeviqin kryeipeshkëv të Zarës, në të cilën detyrë qëndroi 32 vjet.³²¹ Si i deleguar i saj, gëzonte besim të madh të Kongregatës për përhapjen e fesë ashtu që Kongregata i drejtohej për këshillë edhe me rastin e emërimit dhe transferimit të misionarëve, e edhe me rastin e përcaktimit të ndihmave në të holla për misionarët ose misionet e caktuara.³²² Vinko Zmajeviqi,

³²⁰ Ky shkrim është botuar në: "Argjipeshkvi Vinçenc Zmajevich me rastin e 250 vjetorit të vdekjes 1702-1745." Misioni katolik shqiptar Zagreb, 2001, fq. 51-88.

³²¹ Pavao Butorac, Vinko Zmajeviq (1670-1745), Hrvatska Smotra, Viti. XV, nr. 3, Zagreb 1928, fq. 58.

³²² Në regjistrin e përgjithshëm të akteve të Kongregatës për përhapjen e fesë janë të shënuara 392 akte që kanë të bëjnë me kryeipeshkvinë e Shkupit në kohën kur Zmajeviqi e ka kryer shërbimin prej të deleguari. Në të njëjtin regjistër janë të shënuara edhe 1622 akte që kanë të bëjnë me ipeshkvitë në Shqipëri, në kohën prej viteve 1701-1745. Përmbajtjen e shumicës së atyre akteve Zmajeviqi e ka njohur, kurse pjesën më të madhe të zgjedhjeve ai ia ka sugjeruar Kongregatës. Një pjesë e mirë e akteve të përmendura ka të bëjë me françeskanët, të cilët kanë vepruar si misionarë në ipeshkvitë e Shqipërisë dhe në kryeipeshkvinë e Shkupit. Edhe për këto

abat, kryeipeshkëv i Tivarit dhe i Zarës, vizitator apostolik dhe i deleguar apostolik i Kongregatës për përhapjen e fesë, vdiq më 11 shtator 1745. Është varrosur në varrin para Lterit në kishën e Zojës nga Kashtelli (Gospa od Kaštela) në Zarë, ndërtimin e të cilit e ka porositur vetë.³²³

Me qëllim të kuptimit më të mirë të brengave që i kishte kryeipeshkvi Zmajeviq, si i deleguar i Kongregatës, në drejtim të përmirësimit të gjendjes në kryeipeshkvinë e Shkupit pas luftës austriako-turke, menjëherë në fillim të shërbimit të tij emisarik, me anë të dokumenteve bashkëkohore, do ta paraqesë gjendjen shumë të rëndë të kryeipeshkvisë së Shkupit në atë kohë.

Me rastin e emërimit të don Pjetër Karagiqit për kryeipeshkëv të Shkupit në vitin 1702, nuk ka pasur mundësi të sigurohet ndonjë dëshmitar i cili në procesin hulumtues me rastin e këtij emërimi do të dëshmonte për gjendjen në kryeipeshkvinë e Shkupit. Për këtë arsye Kongregata për përhapjen e fesë me sekretarin e saj u shërbyen me relacionin mbi kryeipeshkvinë e Shkupit dhe me promemorien për vete, të cilat don Pjetër Karagiqi ia shkroi Kongregatës në vitin 1692, kur për shkak të luftës u detyrua të largohet nga kryeipeshkvia. Në promemorien e vet, Pjetri thotë për veten se 18 vjet ka shërbyer si misionar në Trepçë, duke i përkrahur katolikët e atjeshëm në fe, krejt deri në thyerjen e fundit të atyre anëve, e cila ndodhi në vitin 1690, kur u detyrua të strehohet në Beograd, duke i lënë të gjitha çka i pat në duart e tartarëve, të cilët edhe e plagosën rëndë në kokë. Në Beograd i shërbeu popullit të ikur deri atëherë kur osmanët e morën përsëri qytetin dhe e plaçkitën. I është dashur të shkojë në Dubrovnik, ku ka lënguar shumë nga sëmundjet infektive, e prej andej shkoi në Romë me qëllim që ta lajmërojë Kongregatën për gjendjen e mjerë të besimtarëve të kryeipeshkvisë së Shkupit.

Kryeipeshkvia e Shkupit gjithmonë e ka pasur kryeipeshkvin e vet, kurse i fundit ka qenë Pjetër Bogdani, i cili nuk ka reziduar në Shkup siç e kanë pasur zakon paraardhësit e tij, por në Janjevë, ku e pat ndërtuar shtëpinë. Kryeipeshkvia i ka pasur njëmbëdhjetë famulli dhe dy kapelani. Njëra kapelani ka qenë në Prokupe dhe i ka pasur 200 katolikë. Vetë e kanë mbajtur famullitarin, i cili ka vdekur. Kapelania tjetër ka qenë në Novi Pazar dhe i ka pasur 30 katolikë. E kanë pasur priftin e vet të cilin e kanë mbajtur tregtarët dubrovnikas, por këtë e vranë ushtarët austriakë.

akte Kongregata e ka pyetur kryeipeshkvin Zmajeviq për këshilla. Është interesant se të gjitha letrat e tij, që i kemi hasur, kryeipeshkvi i ka shkruar me dorë të vet, duke i nënshkruar kryesisht me inicialet V. Z. Një energji e çuditshme ka qenë në atë njeri.

³²³ Pavao Butorac, e njëjta vepër, fq. 59, 62.

Prej njëmbëdhjetë famullive, shtatë prej tyre janë në Serbi (pra, në kryepeshkvinë e Shkupit), kurse katër në Shqipëri (në ipeshkvinë e Prizrenit).

Në Serbi famullia e parë është ajo e Shkupit, e cila i ka 180 katolikë dhe famullitarin e tyre e kanë mbajtur besimtarët, të cilin e vranë tartarët. Në Kratovë ka pasur 80 katolikë. E kanë pasur misionarin e tyre i cili ka vdekur. Famullia e tretë është Cernagora (Letnica) me 500 katolikë, të cilët e kanë mbajtur famullitarin e tyre, të cilin osmanët e patën zënë rob. Në Novobërdë ka pasur 500 katolikë të cilët e kanë mbajtur famullitarin e tyre, të cilin osmanët gjithashtu e zunë rob. Janjeva i ka pasur 600 katolikë, të cilëve u ka shërbyer misionari i emëruar nga Kongregata për përhapjen e fesë, e të cilin po ashtu e vranë osmanët. Famullia e gjashtë është Prishtina e cila i kishte 150 katolikë. Ky ishte misioni të cilit Kongregata për përhapjen e fesë ia emëroi misionarin. Trepçën e kanë pushtuar dhe shkretuar osmanët dhe tartarët. Përveç në famullitë e përmendura, përafërsisht nga 30 katolikë kanë qenë edhe në Krushevc, Nish, Leskovc dhe Medvegjë.

Të gjitha këto vende dhe të gjitha famullitë dhe kapelanitë e përmendura janë plaçkitur nga ushtria perandorake austriake ashtu që nuk i kanë kursyer as kishat, duke i plaçkitur edhe gjërat kishtare. Banorët pjesërisht i kanë vranë e pjesërisht i kanë burgosur, kurse me ardhjen e tartarëve të gjitha këto vende, famulli dhe kapelani kanë mbetur të shkretuara.³²⁴

Don Pjetri në këtë relacion i ka shënuar edhe emrat e famullitarëve dhe të misionarëve,³²⁵ por në përmbledhjen e këtij relacioni, të përgatitur për Procesin hulumtues, të përmendur më parë, emrat e tyre nuk janë.

Pos kësaj, si vikar apostolik i ipeshkvisë së Pultit, i rekomandoi Kongregatës se do të ishte mirë që administrimi i ipeshkvisë së Pultit t'i besohet ipeshkvit të Lezhës, si më të afërmit.³²⁶

Don Tomë Raspasani, letnicas, vikar i kryepeshkvit të Shkupit për Shqipëri, më 1 prill 1690, nga Nishi i raporton Kongregatës për përhapjen e fesë mbi ikjen e tij së pari në Beograd dhe për ardhjen e tij në Nish, ku e thirri gjenerali, konti Veterani, për përkthyes të gjuhës kroate dhe të gjuhës shqipe. Besimtarët kanë ikur andej e këndej për shkak të gjendjes së luftës, kurse në kryepeshkvi kanë mbetur fare pak. Kanë mbetur vetëm disa priftërinj, si don Gjon Bogdani, nipi i kryepeshkëv Pjetrit, dhe don Ivan Jovkoviqi, të dy nxënës të kolegjit në Loreto. Në kryepeshkvi

³²⁴ ASv, Processus Datariae, vll. 79, ff. 45 rv, 46 rv.

³²⁵ ASCPF, Indice Generale degl Atti della Sag. Congregacione dall anno 1688. a tutto I anno 1704. Viti 1692. Servia

³²⁶ Po aty

kanë mbetur don Pjetër Zoganji dhe don Mark Mazreku, nxënës i kolegjit Urban, i cili gjatë ikjes u sëmur dhe për të cilin tani nuk dihet më asgjë. Për priftërinjtë e tjerë don Toma thotë se janë gjallë, por se jetojnë në gjendje të mjerueshme. Nga Prizreni dhe Peja askush nuk ka mundur të shpëtojë duke ikur, kështu që të gjithë kanë mbetur pre e barbarëve. Nuk di se ç'ka ndodhur me ta, sepse është e ndërprerë çdo lidhje me ta. Ai me një prift nga Peja shkoi në Beograd, prej nga e thërrasin në Nish. Pranë të gjitha këtyre lebetive, nuk kanë as të veshura meshtarake, kështu që gjithnjë mbesin pa meshë.³²⁷ Don Tomë Raspasani pastaj shkoi në Vllahi prej nga në vitin 1693 përsëri raportoi për gjendjen e mjerueshme të katolikëve në Serbi dhe në Bullgari. Thotë se ky është strehuar në Vllahi, e don Pal Joshçiqi është liruar nga robëria dhe është kthyer në Serbi, kështu që do të ishte mirë që t'i caktohej ndihma që e ka pasur don Andrej Floriu (Pavlloviqi), nipi i të cilit është zënë rob.³²⁸

Don Pjetër Karaqi së pari u emërua vikar apostolik i ipeshkvisë së Pultit, kurse në mbledhjen e Kongregatës, të mbajtur më 30 shtator 1697, u emërua ipeshkëv i Pultit dhe administrator i kryeipeshkvisë së Shkupit.³²⁹

Si ipeshkëv i Pultit dhe administrator i Shkupit, Karagiqi më 1698 i raportoi Kongregatës se kryeipeshkvia e Shkupit ka mbetur edhe pa priftërinj edhe pa objekte liturgjike.³³⁰ Raportoi se osmanët nga urrejtja ndaj fesë katolike e vranë don Pal Negrin, misionar, në Gjakovë³³¹, e se don Pjetër Zoganji ka mbetur misionari i vetëm në kryeipeshkvinë e Shkupit³³² dhe se don Pal Joshçiqin, pas lirim të tij nga robëria, e dërgoi për misionar në Cernagora (Letnica) dhe Kratovë.³³³

Pas raportit të Karagiqit se kryeipeshkvia e Shkupit ka mbetur pa objekte liturgjike, Kongregata përmes tij i dërgoi gjërat e nevojshme. Katolikët e Janjevës më 10 gusht të vitit 1699, me falënderimin e vet i vërtetojnë Kongregatës se përmes monsinjorit Karagiq, ipeshkvit të Pultit dhe administratorit të kryeipeshkvisë së Shkupit, i kanë marrë kelkun, patenën, Mesharin dhe “të tjerat”.³³⁴ Katolikët në Gjakovë gjithashtu i kanë fituar gjërat e nevojshme për meshim, prandaj në emër të të gjithë anëtarëve të famullisë Kongregatës i falënderohen: Dedë Sarati, Lekë Nikollini, Gjeç Gega, Kolë Jovani, Anton Nikollini, Anton

³²⁷ ASCPF, SC, Servia, vll. I, f. 189 rv.

³²⁸ ASCPF, Indice Generale, Viti 1693. Servia

³²⁹ Asv, Processus Datariae, vll. 75. f. 205 rv.

³³⁰ ASCPF, Indice Generale, Viti 1698. Servia

³³¹ Po aty

³³² Po aty

³³³ Po aty

³³⁴ ASCPF, SC, Servia, vll. I, f. 218.

Sebastiani, Mara Prençi, Pezzo Pavlloni, Juraj Simonovi, Menna Pavllovi, Pjetër Nataleovi dhe Kolë Marku.³³⁵

Edhe katolikët e Shkupit falënderohen më 20 gusht të vitit 1699, për objektet liturgjike, të cilat i fituan nga Kongregata për përhapjen e fesë përmes ipeshkvit të Pultit dhe administratorit të kryeipeshkvisë së Shkupit, Pjetër Karagiqit.³³⁶

Edhe don Pal Joshçiqi me letrën e 20 shtatorit 1698, drejtuar Kongregatës nga Kratova, e ndriçon situatën e asaj kohe. Don Pali thotë se ipeshkvi i Pultit dhe administratori i kryeipeshkvisë së Shkupit, sipas të gjitha gjasave, i ka raportuar Kongregatës për veprimtarinë e tij. Don Pali këtë e bëri tani, sikur në vitin 1692 kur i raportoi Kongregatës për veprimtarinë e vet. Prej atij viti u shërben besimtarëve në Kratovë, Kumanovë, Shkup, Cernagora (Letnica), Prizren, Prishtinë, Vuçitërnë dhe në shumë fshatra të cilat gjinden në rrethinë të këtyre qyteteve. Udhëton edhe nga tetë ditë që të arrijë te disa katolikë. Mahmut pasha e kishte zënë rob, por kur më 1692 ai e bleu lirinë e vet me shumën prej 380 realësh, filloi t'i vizitojë katolikët në Sofje, Beograd dhe Temishvar, ku nuk ka qenë asnjë misionar. Kështu, udhëtonte vetëm nga dashuria ndaj besimtarëve që ata ta ruanin fenë e vet. Në Temishvar qenë 70 katolikë përafërsisht aq ishin edhe në Beograd, kurse në Sofje qenë 30 sish. Prej vitit 1682 deri më 1698 i pagëzoi 700 fëmijë. Kur shkonte në Sofje, në Temishvar dhe në Beograd, e zëvendësonte në punë don Pjetër Zogani, misionar nga Hasi deri sa kthehej ai. Njëherë, kur shkoi në Beograd, e zunë jeniçerët dhe e dërguar te veziri suprem, duke e akuzuar se ishte spiun. E kishin hedhur në gjunjë për t'ia prerë kokën, por ky ua tregoi letrën për arrestimin e tij të mëhershëm dhe kështu e shpëtoi kokën. Sikur t'i përshkruante të gjitha përjetimet e këtyre gjashtë viteve, nuk do të mjaftonte vetëm kjo letër. Nëse Kongregata nuk do t'i ndihmonte materialisht, do të detyrohej të shkojë e të kërkojë lëmshë ose nga perandoria austriake apo Stambolli, që të mund të jetonte. Të gjitha këto i shkroi që ta lehtësojë ndërgjegjen e vet. Vikari apostolik i Pultit, Karagiqi aso kohe nuk kishte kënd ta dërgojë në Kratovë, në Kumanovë, Shkup dhe Cernagora (Letnica), prandaj e dërgoi atë, sepse ai i njihte gjuhët që nevojiteshin në këto misione. Fra Bernardini në Cernagora (Letnica) merrte ndihmë prej 20 shkudësh, kurse don Vinko Vllashçiqi në Kratovë gjithashtu i merrte njëzet shkudë nga Kongregata. Kurse ai, që tani shërbente edhe në Cernagora (Letnica) dhe në Kratovë, gjatë gjithë këtyre 6 viteve nuk mori kurrfarë ndihme.³³⁷ Me letrën e 7 janarit

³³⁵ ASCPF, SC. Servia, vll. 1. f. 219.

³³⁶ ASCPF, SC. Servia, vll. 1. f. 221.

³³⁷ ASCPF, SC. Servia, vll. I. 217. rv.

1701, don Pal Joshçiqi misionar në Kratovë, falenderon Kongregatën për ndihmat gjatë tetë viteve të kaluara.

Imzot Karagiq do të përkujdeset, në marrëveshje me Kongregatën që ai mos të ketë më nevojë të shkojë në Sofje, në Beograd dhe Temishvar, që të mund t'i kushtojë më tepër kujdes punës në misionet e tij.³³⁸

Në vitin 1698, me të kryer të studimeve në kolegjin Urban në Romë, don Gjergj Bogdani i erdhi ipeshkvit dhe administratorit Karagiq në Shioshi, në ipeshkvinë e Pultit, ku rezidonte ai. Për ardhjen e tij Karagiqi e lajmëroi Kongregatën, e pasi don Gjergji ka qenë në dispozicion të Kongregatës, administratori i kryeipeshkvisë së Shkupit kërkon që ky të dërgohet si misionar në kryeipeshkvinë e Shkupit.³³⁹ Në vitin vijues, më 1699, don Gjergji u vërtetua për misionar në Janjevë, kurse don Pal Joshçiqi përsëri u vërtetua për misionar në Kratovë. Në bazë të lutjes se Vinko Zmajeviqit, abatit nga Perasti, të dyve u është përcaktuar ndihma vjetore prej 25 shkudash.³⁴⁰

Si administrator i kryeipeshkvisë së Shkupit, Karagiqi e sjell nga Shqipëria don Mark Bianchin dhe e emëron famullitar në Gjakovë në vend të don Pal Negrit, të cilin e vranë osmanët.³⁴¹ Don Marku, në vitin 1699 i shkroi Kongregatës letër lëvdate për fra Pjetër Romanon (di Vicovaro) për të cilin thotë se është në mëshirën e pashait në Pejë, sepse merret me mjekim.³⁴² Në përpjekjet që kryeipeshkvia e Shkupit të fitojë priftërinj, Karagiqi në vitin 1699 e lut Kongregatën që të ruhen tre vende, të cilat janë të parapara për nxënës nga kryeipeshkvia e Shkupit: një në kolegjin Urban, një në Fermo dhe i treti në Loreto; dhe i propozon dy djelmosha, njëri prej të cilëve do të duhej të vendoset në “vendin e Imzotit Vives”³⁴³ d.m.th. në njërin nga vendet fondative, në të cilat nxënësi mbahej me kamatat e fondit të caktuar. Administratori Karagiq, në vitin 1699 i raportoi Kongregatës për punën e vet dhe për punën e misionarëve, don Mark Bianchit në Gjakovë, don Pjetër Zoganjit në Has dhe don Pal Joshçiqit “në Serbi dhe në vendet e tjera”. Përgjigjja e Kongregatës në këtë relacion të Karagiqit qe paralajmërimi i pagesës së ndihmave të skaduara të don Pal Joshçiqit.³⁴⁴ Të njëjtin vit iu rrit ndihma don Gjergj Bogdanit, misionarit në Janjevë, për shkak se shërbente edhe

³³⁸ ASCPF, SC. Servia, vll. I. f. 231.rv.

³³⁹ ASCPF, Indice Generale, Viti 1698. Servia

³⁴⁰ ASCPF, Indice Generale, Viti 1699. Servia

³⁴¹ Po aty

³⁴² Po aty

³⁴³ Po aty

³⁴⁴ Po aty

në fshatrat e ish-misionit të Trepçës, kështu që ky tani merrte 35 shkuda, ndihmë në vit.³⁴⁵

Të njëjtin vit, në Kongregatë diskutohej mbi dërgimin e misionarëve në Temishvar dhe Sofje, ku shkonte don Pal Joshçiqi. Kardinali Kolloniq mendonte se nuk do të ishte mirë që t'u dërgohej katolikëve në Temishvar dhe Sofje misionari derisa nuk caktohen kufijtë dhe i shkroi Kongregatës se ai është përkujdesur për hyrje të lirë të etërve françeskanë në Temishvar. Kongregata e luti kardinalin që për këtë t'i shkruante edhe një herë.³⁴⁶

Ipeshkvi i Pultit dhe administratori i Shkupit e dërgoi në kryepeshkvinë e Shkupit patër Filipin nga Shkodra që të vëzhgojë se a kishte mundësi të vinin françeskanë të tjerë. Për këtë arsye, në vitin 1700 e lut Kongregatën që pater Filipit t'i jepet leja të udhëtojë nëpër Serbi i veshur si laik.³⁴⁷

Në mbledhjen e Kongregatës, të mbajtur më 19 korrik 1701 ipeshkvi i Pultit, Pjetër Karagiqi u emërua kryepeshkëv i Shkupit, pas dorëheqjes se pater Daniell Durantit, i cili dha dorëheqje për shkak të sëmundjes dhe të mosnjohjes së gjuhës shqipe.³⁴⁸ Në letrën e shkruar më 15 tetor 1701, në fshatin Shiohi, Karagiqi e falënderon Kongregatën për këtë emërim.³⁴⁹ Në mesin e dokumenteve të procesit hulumtues gjendet edhe dëftesa të cilën në bazë të dokumenteve nga arkivi i Kongregatës, e ka shkruar sekretari i tij, Karl Augustin Fabroni, me të cilën dëshmon se Pjetër Karagiqi si ipeshkëv i Pultit i ka ndarë popullit sakramente dhe ka kryer funksione pontifikale.³⁵⁰

Në kohën e këtij emërimi kryepeshkvia e Shkupit i kishte tre priftërinj shekullarë: don Pjetër Zoganjin, don Pal Joshçiqin dhe don Gjergj Bogdanin, famullitar në Janjevë, i cili para disa vitesh kishte ardhur nga studimet të cilat i vijonte në Itali (gabimisht shkruan se erdhi nga studimet në Loreto). Këta priftërinj kanë qenë edhe kandidatët e vetëm të mundshëm për kryepeshkëv të Shkupit. Mirëpo, Kongregata mendoi se do të ishte më mirë që ipeshkvin e Pultit, Karagiqin ta transferojë në kryepeshkvinë e Shkupit, sepse ky ka qenë prift i kësaj kryepeshkvie (nga Novobërda), e njihnte gjuhën kroate, turke dhe shqipe, e gjithashtu në kryepeshkvinë e Shkupit e ka pasur edhe familjen dhe ka qenë i shquar edhe te katolikët dhe te myslimanët, respektivisht te pushteti turk. Këtë transferim të Karagiqit e ka propozuar ipeshkvi i

³⁴⁵ Po aty

³⁴⁶ Po aty

³⁴⁷ ASCPF, Indice Generale, Viti 1700. Servia

³⁴⁸ ASV, Poccus Patariae, vll. 79. f. 44.

³⁴⁹ ASCPF, SC. Servia, vll. 1. f. 233.

³⁵⁰ ASV, Processus Datariae, vll. 79. f. 46. v.

Lezhës, kurse Kongregata e kishte aprovuar. Si i përshtatshëm, për trashëgimtar të Karagiqit në ipeshkvinë e Pultit, u propozua don Marin Gjini. I njëjti ipeshkëv i Lezhës i shkroi Kongregatës se nuk do të ishte mirë që ipeshkvia e Pultit të mbetet pa ipeshkëv tani, kur me zellin e imzot Karagiqit u arrit që besimtarët e atjeshëm, të cilët kanë qenë të lënë pas dore, të edukohen në një përshtatshmëri dhe devocion.³⁵¹

Gjithmonë pas tronditjeve të mëdha shoqërore siç janë luftërat, me të cilat bëhen ndryshime të mëdha në ipeshkvitë e përfshira me luftë, Selia e Shenjtë dërgonte vizitorë që të konstatojnë gjendjen faktike dhe të rekomandojnë mjetet për përmirësimin e gjendjes së besimtarëve në ato ipeshkvi. Me të njëjtin motiv e emëroi edhe Vinko Zmajeviqin për vizitor të Shqipërisë, Maqedonisë dhe Serbisë. Ne nuk e kemi relacionin e Zmajeviqit për atë vizitë, gjatë të cilit kryeipeshkvi e kryesoi Koncilin Krahinor i cili në dokumente quhet Koncili Shqiptar.

Në letrën e 4 tetorit 1703, të shkruar në Zym të Hasit, kryeipeshkvi Pjetër Karagiqi i raporton Kongregatës për përhapjen e fesë së vizitorit Zmajeviq dhe atij i kishte ndihmuar shumë bujari Bolica, i cili erdhi në Shkodër së bashku me vizitorin. Pasi që në kohën e ardhjes së tyre Oda pasha ishte në Podgoricë, këta shkuan atje, që vizitori t'i prezantohej personalisht. Bujari Bolica ia rekomandoi pashait kryeipeshkvin Zmajeviq, e rekomandimi qe efikas, sepse në bazë të këtij rekomandimi vizitori i vizitoi të gjitha viset e Shqipërisë dhe e pa tërë mjerimin e secilës ipeshkvi, e posaçërisht atë të kryeipeshkvisë së Shkupit, të cilën e shkretuan së pari ushtarët e ushtrisë perandorake austriake, e pas tyre osmanët dhe tartarët, kështu që ai u shkreh në vaj, me të parë mjerimin e saj. Vizitori kishte shpenzime të mëdha, sepse ka qenë i detyruar t'i japë dhurata pashait dhe komandantëve të tjerë turq. Po t'i përmendte të gjitha ato shpenzime, kardinalët e Kongregatës do të mbeteshin të habitur. Koncili Krahinor ka qenë mjaft solemn, e aty kanë qenë dy kryeipeshkvi, katër ipeshkvi, një abat, dy prefektë françeskanë, katër vikarë gjeneralë, e shumë priftërinj dhe besimtarë laikë. Për atë se si në fshatin Mërçijë në ipeshkvinë e Lezhës, në muajin janar të vitit 1703, është mbajtur Koncili Krahinor dhe se me çfarë solemnitetesh dhe në mënyrën e cila nuk është e zakonshme në Turqi, vizitori deri në imtësi do t'i raportojë Kongregatës. Pasi kryeipeshkvi Karagiq i njeh ipeshkvitë në Shqipëri të gjitha viset e atjeshme, por edhe për shkak të njohjes së gjuhës shqipe, e përcolli vizitorin në këtë vizitë katër muaj rresht. Kongregata, vërtet nuk ka mundur të gjejë person më të mirë dhe më të denjë për vizitën e atyre viseve, i cili do të ishte i barabartë me imzotin Vinko Zmajeviq, njeriun aq të arsyeshëm, aq të shkathët, aq të

³⁵¹ 31 ASCPF, SC. Servia, vll. 1, f. 612r, 6133.

ditur dhe të durueshëm në mundime dhe kundërshtime. Të gjitha këto virtyte vizitatori i tregoi duke i vizituar ipeshkvitë e Pultit, Shkodrës, Sapës dhe Lezhës, e kryeipeshkvitë e Shkupit dhe Durrësit. Shkonte në vende malore duke i vizituar me gjakim, interesim, zell dhe përpikëri, duke mos i përfillur mundimet e ndryshme dhe të pareshtura. Nëpër shumë vende ka shkuar këmbë, sepse atje nuk mund të shkohej as me kalë. Kaloi nëpër shumë vende të shkreta dhe të pabanuara, përtej lumenjve shumë të rrezikshëm. Shpeshherë ka ngjarë të udhëtojë tërë ditën nëpër shi, e pastaj të shkojë në shtëpitë e varfanjakëve i lagur dhe të flejë në pak kashtë, në tokë të thatë, në rrobat e tij të lagura. Me çka është ushqyer dhe çka ka pirë, kardinalët e Kongregatës mund ta dinë, duke e ditur se sa e madhe ishte varfëria në ato vise të varfra. Gjatë vizitë it të Shkupit dhe qyteteve të tjera të kryeipeshkvisë së Shkupit, të dytë e kanë përjetuar rrezikun e drejtpërdrejtë të vdekjes, sepse mu në atë kohë ka arritur urdhri i sulltanit që të vriten të gjithë priftërinjtë shekullarë, françeskanët dhe ipeshkvijtë si shkatërrimtarë të fesë skizmatike të grekëve dhe armenëve, nën nxitjen e të cilëve sulltani e dha këtë urdher. Që të mos jetë tepër i hollësishëm, Karagiqi e len mënjatë përshkrimin e mundimeve të pafund dhe rreziqeve të tjera. Por për atë, Zoti ka dhënë që vizitatori të shfrytëzojë ndihmën dhe nderimin që ia ka bërë Oda pasha, kurse imzot vizitatori Zmajeviq u ka mbetur në kujtesë të përhershme si ipeshkvijve, rregulltarëve dhe priftërinjve shekullarë, ashtu edhe besimtarëve laikë, të cilët çuditen që në një njeri të ri kanë parë dituri, arsyeshmëri dhe shkathtësi aq të madhe.³⁵²

Patër Filipi nga Shkodra, të cilin Karagiqi e dërgoi në kryeipeshkvinë e Shkupit që të vëzhgojë mundësinë e ardhjes së misionarëve të tjerë, i raportoi në vitin 1702 Kongregatës, mbi nevojën për misionarë në kryeipeshkvinë e Shkupit, kurse prokuratori i misioneve françeskane i propozoi katër kandidatë dhe luti që t'u sigurohet ndihmë dhe t'u jepet leja që të mund të udhëtojnë në kalë dhe në rroba laike.³⁵³ Prej këtyre të katërve në kryeipeshkvinë e Shkupit u dërguan dy françeskanë.³⁵⁴

Në letrën e shkruar Kongregatës, prej Zymit të Hasit, më 10 nëntor 1703, kryeipeshkvi Karagiq thotë së tashmë një herë ka lajmëruar për vdekjen e misionarit të mirë dhe të zellshëm, Pjeter Zoganjit, i cili vdiq muajin e kaluar, në qershor. Që në vendin e tij, në Gjakovë, Zoganje dhe fshatërat përkatëse të tyre, ta emërojë tjetrin, e kërkoi një prift në ipeshkvinë e Sapës dhe ipeshkvitë e tjera të Shqipërisë, por nuk e fitoi atë që ka qenë i propozuar për ato misione. Atëherë, e luti patër Egidin

³⁵² ASCPF, SC. Servia, vll. 1. f. 243rv.

³⁵³ ASCPF, Indice Generale, Viti 1702. Albania

³⁵⁴ ASCPF, Imdice Generale, Viti 1702. Albania, Servia.

(d'Armento, mbiemri i të cilit ka qenë Quinto, vërejtje e autorit), prefektin françeskan. Prefekti ia dërgoi patër d'Orsigliaden së bashku me një vëlla laik, mjek, fra Augustin da Civitellën. Kryeipeshkvi i vendosi në Zoganje afër Gjakovës dhe aty ishin që nga muaji gusht. Kjo është vetëm zgjidhje e përkohshme derisa nuk e caktohet ndonjë prift nga nxënësit në Romë, Loreto dhe Fermo. Karagiqi u shpërngul nga ipeshkvia e Pultit në Zym të Hasit, sepse nuk mund të banonte në qytet, për shkak të dhunës dhe terrorit turk.³⁵⁵ Patër Salvatore nuk e ka pasur lehtë ashtu i vetëm në dy misione, prandaj me letrën e 15 janarit 1706, si misionar dhe sekretar i kryeipeshkvit, e lut Kongregatën që t'ia ndajë urdhrat klerikale, vëllait Augustin da Civitellos, që të mundet të shugurohet për prift më vonë, sepse është shumë i zellshëm në shëlbimin e shpirtrave, është rregulltar i mirë, i arsyeshëm dhe e njeh gjuhën shqipe dhe atë kroate. Përveç kësaj i njeh këto vise, sepse këtu ka jetuar rreth 11 vjet.³⁵⁶ Edhe kryeipeshkvi Karagiq me letrën e 4 marsit 1706 ia rekomandon Kongregatës laikun fra Augustin që t'i ndahen urdhrat klerikalë, sepse si prift do t'ju shërbente shumë besimtarëve.³⁵⁷ Kur patër Salvatore bëri lutje që të vërtetohet për misionar me ndihmë prej 25 shkudash, Kongregata ia la kryeipeshkvit Vinko Zmajeviq, të merrte vendim për këtë.³⁵⁸

Në relacionin e 20 majit të vitit 1706, kryeipeshkvi Karagiq e përshkruan situatën në kryeipeshkvinë e Shkupit dhe prej këtij raporti shihet se tani të gjitha misionet dhe famullitë ekzistuese i kanë priftërinjtë e vet. Kryeipeshkvi në dy vitet e fundit është përpjekur që t'i vizitojë të gjitha misionet e kryeipeshkvisë dhe administraturës së vet (pra, misionet dhe famullitë e ipeshkvisë së Prizrenit). Nuk i ka pasur gjithmonë rrethanat e volitshme për vizitë . Për këtë shkak edhe është vonuar pak. Në Peshter i krezmoi 500 persona. Ky mision i kishte 2000 katolikë, kurse misionarë të tyre ishin patër Anton di Monte Muro, patër Zef da Gabiate dhe një vëlla laik, ndihmës i tyre. Në Pejë i krezmoi 60 persona. Edhe kjo famulli i kishte 2000 frymë katolike, kurse misionarë të tyre qenë patër Pjetër di Vicovaro (Romano), patër Karl Milanese dhe patër Karl da Monte Fortino. Në Gjakovë i krezmoi 100 persona, e ky mision (së bashku me Zoganjen) i kishte 2100 katolikë, misionarët e të cilëve janë patër Salvatore d'Orsigliade, patër Ilario da Monte Fortino dhe vëllai ndihmës, Augustin da Civitella. Në Has i krezmoi 10 persona, e aty janë 300 frymë katolike, misionar i të cilëve është don Mark Bianchi, i

³⁵⁵ ASCPF, SC. Servia. vll. 1., f. 245. Angjelës, nënës së ish-misionarit, don Pjetër Zoganjit, i është paguar shuma në lartësi prej ndihmës gjysmëvjetore, ashtu që ajo ta paguajë borxhin prej 40 shkudash, i cili ka mbetur pas tij, e të cilën shumë e ka huazuar ajo me rastin e vdekjes së tij. Indice Generale. Viti 1704. Servia.

³⁵⁶ ASCPF, SC. Servia, vll. 1., f. 249.

³⁵⁷ ASCPF, SC. Servia, vll. 1., f. 251.

³⁵⁸ ASCPF, Indice Generale, Viti 1704. Servia.

cili i pagëzoi 25 fëmijë. Në Prizren i krezmoi 30 persona, kurse në qytetin e Prizrenit me fshatrat përreth qenë 900 katolikë. Misionari i tyre don Anton Lindi, i pagëzoi 129 fëmijë. Në Janjevë dhe Prishtinë i krezmoi 26 persona. Në këto dy vende qenë 300 katolikë, kurse misionari i tyre, don Gjergj Bogdani i pagëzoi 150 fëmijë. Në misionin e Kratovës, në të cilin përfshihen Shkupi dhe Cernagora (Letnica), i krezmoi 31 persona. Ky mision në të tre vendet i ka 170 frymë katolike, kurse misionari i tyre, don Pal Joshçiqi, i pagëzoi 10 fëmijë. Të dhënat për të pagëzuarit sikur edhe të dhënat e tjera për misionet e Peshterit, Pejës dhe Gjakovës (me Zoganje) do t'i dërgojnë misionarët e tyre përmes prefektit të tyre.³⁵⁹

Kryeipeshkvi i Tivarit, Vinko Zmajeviq, më 1704, bazuar në raportet e tij mbi vizitë in e ipeshkvive në Shqipëri dhe kryeipeshkvisë së Shkupit, me brevin papnor u emërua i deleguar me autorizime të mëdha lidhur me implementimin e vendimeve të Konkilit Shqiptar dhe të vendimeve që i ka sjellë Kongregata për përhapjen e fesë. Në mes tjerash e fitoi edhe autorizimin për “shkarkimin e famullitarëve të papërshtatshëm.”³⁶⁰ Kështu, p.sh. Kongregata, në bazë të raportit të Zmajeviqit, ia dha komisarit gjeneral të françeskanëve të reformuar obaservantë, listën e françeskanëve të papërshtatshëm për misione, kurse kardinalit Bichi si të papërshtatshëm për shërbim ia shënoi edhe vetë komisarin gjeneral.³⁶¹ Në frymë të brevës papnore, vizitatori Zmajeviq ia tërhoqi vërejtjen ipeshkvit të Lezhës “në mënyrë atërore”, kurse Kongregatës i shkroi “se do të mund të shpresohet në ndonjë rezultat nëse do të ndërmerret diçka më efektive, po edhe suspendimi ose largimi nga shërbimi ipeshkvor”.³⁶² Sipas propozimit të vizitatorit, Kongregata nuk i dha leje don Gjergj Bogdanit që të shkojë në Itali, për t'i jetësuar disa nevoja të tija dhe i urdhëroi që të qëndrojë në famullinë e vet, kurse sekretari i Kongregatës do t'i ndihmojë, nëse ky dëshiron t'i dërgojë dokumentet për ato nevoja të tija.³⁶³

Vizitatori propozoi që të merret parasysh misioni françeskan i Pejës për përcaktim të ndihmës prej 50 shkudash.³⁶⁴ Nën rekomandim të vizitatorit, don Pal Joshçiqi u emërua vizitator apostolik në Bullgari, për të njoftuar për situatën e misionarëve të atjeshëm. Sa i përket shpërblimit për atë vizitë, Kongregata thotë se për këtë do të vendosë kryeipeshkvi Zmajeviq.³⁶⁵

³⁵⁹ ASCPF, SC. Servia, vll. I., f. 253.rv.

³⁶⁰ ASCPF, Indice Generale, Viti 1704. Albania.

³⁶¹ Po aty

³⁶² Po aty

³⁶³ Po aty

³⁶⁴ Po aty

³⁶⁵ Po aty

Vizitatori rekomandoi ngritjen e misionit në Peshter me ndihmë vjetore prej 30 shkudash.³⁶⁶ Në raportin mbi këtë vizitë Zmajeviçi shkroi shumë propozime, kurse Kongregata i pranoi të gjitha. Në shenjë mirënjohjeje për vizitë in e ndërmarrë, Kongregata i dha vizitorit 500 shkuda, kurse për rindërtimin e kishave dhe nevojat të tjera ia dha 1.000 shkuda që t'i shpërndajë si dëshiron vetë.³⁶⁷ Përveç kësaj Kongregata ia rekomandoi edhe papës që ai nëpër kanalet diplomatike të fitojë nga Republika e Venedikut ndonjë ndihmë materiale, e cila Zmajeviçit do t'i paguhej përmes Datarisë.³⁶⁸ Përveç të gjitha këtyre, Kongregata ia dha edhe 500 shkuda për furnizimin e kishave të përmendura në relacion, me objekte liturgjike.³⁶⁹ Në raportin për këtë vizitë Zmajeviçi ia rekomandoi Kongregatës shtypjen e dokumenteve të Koncilit Shqiptar në gjuhën shqipe dhe latine.³⁷⁰

Në vitin 1705, kryeipeshkvi Zmajeviçi, i raporton Kongregatës se e shpëtoi misionarin françeskan në Cernagora (Letnica) nga masakra turke dhe se misioni në Pejë gjendet përpara rrezikut të njëjtë.³⁷¹

Me letrën e shkruar në Perast, më 31 maj 1708, kryeipeshkvi Zmajeviçi i raporton Kongregatës për përhapjen e fesë, se shpërngulja e Klementinëve nga Peshteri në vendbanimet e vjetra të tyre në Shqipëri, iu dha përfaqësuesve vendas të pushtetit turk shtytje edhe më të madhe në urrejtjen dhe marrjen e vendimit për t'i ndjekur françeskanët nga misionet në Serbi. Përfaqësuesit e pushtetit supozojnë se françeskanët e kanë nxitur këtë shpërngulje. Kryeipeshkvi e ka paraparë se kjo mund të reflektohet keq në misionet e tjera në Shqipëri. Për këtë arsye prefektit të atjeshëm i urdhëroi që të heqë dorë nga themelimi i misionit të ri për Klementinët, i cili sapo kishte filluar, ashtu që osmanët të mos fillojnë përndjekjen në të gjitha misionet. Kryeipeshkvi nuk u mashtrua në parashikimet e veta, sepse dyshimi megjithatë ra në françeskanët e Serbisë. Turqit u ngritën jo vetëm kundër tyre, por edhe kundër të gjithë priftërinjve në vend. Vendimet e para barbare erdhën nga kulmi i pushtetit nën shkasin e vendosjes së sigurisë në vend duke u përpjekur që të vendoset vetëm një besim. Me përndjekjen e priftërisë do të përndiqej edhe feja katolike edhe emri katolik prej këtyre viseve. Për këtë arsye, të ngjyrosur edhe me shkase të tjera, ndodhi përndjekja e etërve misionarë dhe priftërinjve të tjerë që gjendeshin nën pushtetin e pashait të atjeshëm. Pesë françeskanë u burgosën. Si i besuar i

³⁶⁶ Po aty

³⁶⁷ Po aty

³⁶⁸ Po aty

³⁶⁹ Po aty

³⁷⁰ Po aty

³⁷¹ ASCPF, Indice Generale, Viti 1705, Albania.

Kongregatës, kryeipeshkvi ka qenë i obliguar që këtyre françeskanëve t'u ndihmojë me mjetet e zakonshme të cilat janë kërkuar, madje edhe me dhurata. Në emër të vetin i dhuroi pashait dy orë të bukura, pemë të ziera në sheqer, lule artificiale dhe galanteri të tjera italiane. Kështu, e ndali dhunën barbare, kurse françeskanët dhe priftërinjtë e tjerë qenë lënë dhe janë në rahat dhe siguri, edhe pse patriku skizmatik i Pejës u është kërcënuar me përndjekje të re. Kardinalët e Kongregatës duhet të dinë se në Turqi nuk ka mënyrë tjetër për t'i tejkaluar vështirësitë veçse me dhurata, e ajo është binjake e egërsisë, e cila është gjithmonë armik i drejtësisë dhe e cila është gjithmonë e gatshme për brutalitet nga interesi, para së cilës zhduken edhe interesat shtetërorë edhe ata fetarë. Kryeipeshkvi nga përvoja e vet e gjatë e di se ç'duhet bërë dhe gjithmonë është i pikëlluar, ai e sheh se duhet të ndihmojë kur feja katolike është në rrezik, e nuk mund të bëjë asgjë për shkak të varfërisë së vet. Gjithmonë ka shpenzime të cilat i kalojnë mundësitë e tij. Gjithnjë merr borxhe, e këto borxhe nuk do ta shqetësonin sikur të kishte mundësi për t'i kthyer. E tërë Shqipëria, Serbia, Maqedonia, e tash edhe Bullgaria kërkojnë ndihmë vetëm nga ai. Sikur ta kishte një thesar me të holla nuk do të mund t'i kënaqte të gjitha nevojat e tyre të përhershme. E lut Kongregatën për ndihmë që të mund ta kryejë detyrën e të besuarit apostolik. Nuk lut për vete ose për komoditetin e tij personal, por vetëm për të mirën e fesë dhe të besimtarëve. Nga shtëpia dhe familja Bolica tani nuk gjendet askush që do të mund t'u ndihmonte misioneve të atjeshme përveç bujarit Jeronim Buqës, nipit të bujarit të vjetër Bolicës. Bujari Jeronim sikur edhe daja i tij, është religjioz dhe i angazhuar për interesa të fesë katolike në krahinat e besuara mbikëqyrjes së Zmajeviqit. Kryeipeshkvi u vërtetua për këtë tanimë në shumë raste që kanë të bëjnë me misionet ne Serbi. Për këtë i bëri lutje Kongregatës që bujarin Jeronim ta emërojë mbrojtës dhe mbikëqyrës të misioneve, që t'i japë nxitje edhe më të madhe për të ndihmuar në rastet e ardhshme kur do të nevojitet ndihma për gjërat fetare. Gjithashtu bëri lutje që Jeronimit t'i jepet titulli dhe beneficionet diplomatike çfarë i kishte fituar Bolica i ri në fillim të veprimtarisë së vet për dobi të misioneve. Jeronimi i meriton këto si për shkak të prejardhjes së tij bujare dhe të karakteristikave personale, ashtu edhe për shkak të meritave të atit të tij, i cili gjithashtu i mbronnte dhe i përfaqësonte me sukses interesat e misionarëve.

Prefektit françeskan në Serbi i skadoi afati i shërbimit trevjeçar dhe dëshiron të ketë trashëgimtar në mënyrë që ky të kthehet në provincën e vet. Vendimi i tij është i arsyeshëm, kurse në këto ngjarje, ndërrimi është edhe i nevojshëm. Zmajeviqi mendon se për këtë shërbim do të ishte i përshtatshëm patër Bonifacie da Spoleto, si rregulltar shembullor dhe i zellshëm, i cili përveç tjerash merret edhe me mjekim

dhe për këtë arsye u është shumë i nevojshëm misionarëve në Serbi. E përveç kësaj ka sharm dhe në mënyrë të posaçme di ta fitojë simpatinë e turqve.³⁷²

Përmendëm se Zmajeviqi i vlerësoi disa françeskanë si të papërshtatshëm për misione. Ashtu i vlerësoi kryesisht pse disa prej tyre nuk e njihnin gjuhën shqipe. Me dëshirë që misionarët italianë qysh gjatë studimeve të mësojnë gjuhën shqipe, në vitin 1709 propozoi që për lektor të gjuhës shqipe në kolegjin misionarik françeskan të Shën Pjetër Montorios, të emërohet patër Salvatore d'Origliade, ish misionar në Zoganje dhe Gjakovë.³⁷³

Patër Ilario da Monte Fortino, prefekt i françeskanëve të reformuar në Serbi, në vitin 1710, kërkoi nga Kongregata ndihmë për ndërtimin e hospiciumit në Rugovë,³⁷⁴ kurse kryeipeshkvi Zmajeviq po atë vit iu përgjigj Kongregatës se tani për tani nuk e sheh të udhës themelimin e misionit në Rugovë.³⁷⁵ I njëjti prefekt më 1711, kërkoi leje që vëllai françeskan laik, fra Venancie da Pentima të shugurohet prift. Kongregata u përgjigj se për këtë duhet kërkuar mendimin e kryeipeshkvit të Tivarit.³⁷⁶ Kryeipeshkvi Zmajeviq i përgjigjet Kongregatës se ai dëshiron ta shugurojë prift fra Venancion, që ky të shërbejë në misionet e Serbisë, pasi që merret me mjekim Kongregata nuk ka pasë kësi prirje,³⁷⁷ por në vitin 1713., lejoi që fra. Venancio të shugurohet për prift.³⁷⁸

Më 28. shkurt 1711, kryeipeshkvi Zmajeviq i lajmëroi Kongregatës mbi vdekjen e don Gjergj Bogdanit, misionarit të Janjevës. Trashëgimtar të tij e emëroi don Gjon Prengën, ish-nxënësin e kolegjit të Loretos, për të cilin Zmajeviqi mendon se do të veprojë me sukses si misionar. Për këtë i bëri lutje Kongregatës që ta vërtetojë për misionar në Janjevë dhe t'ia caktojë ndihmën prej 25 shkudash, e cila do t'i mjaftojë. Në shqyrtimin e këtij relacioni në mbledhjen e Kongregatës, të mbajtur më 23 mars 1711 sekretari i Kongregatës shtoi se i lartpërmenduri Prenga edhe në vitin 1708 e ka zëvendësuar don Gjergjin e ndjerë, i cili atëbotë ishte për shërim në Romë. Atëherë kryeipeshkvi Zmajeviq pati propozuar që don Gjergji të marrë 35 shkuda ndihmë vjetore, për çka u diskutua në mbledhjen e 25 shkurtit të vitit 1709. Tani kur vdiq Bogdani, ndihma mund të zvogëlohet në 25 shkuda, sepse don Gjergji ka qenë prift i cili kishte shpenzime më të mëdha.

³⁷² ASCPF, SOCG, VII. 563, ff. 321. rv., 322 rv.

³⁷³ ASCPF, Indice Generale, Viti 1709, Albania

³⁷⁴ ASCPF, Indice Generale, Viti 1710, Servia

³⁷⁵ ASCPF, Indice Generale, Viti 1710, Albania, Varie.

³⁷⁶ ASCPF, Indice Generale, Viti 1711, Servia, Regolari.

³⁷⁷ ASCPF, Indice Generale, Viti 1709, Albania, Varie.

³⁷⁸ ASCPF, Indice Generale, Viti 1713, Servia, Regolari.

Në letrën e përmendur kryeipeshkvi Zmajeviq bëri lutje për një vend në kolegjin e Loretos, për të riun Mihill Summën, lutje të cilën e ka bërë disa herë, por nuk ka marrë përgjigje. Sipas urdhrut të sekretarit të Kongregatës, në lutjen e kryeipeshkvit të 16 dhjetorit të vitit të kaluar u përgjig se Mihilli do të pranohet në kolegjin e Fermos, por kryeipeshkvi Zmajeviq nuk e mori me kohë këtë përgjigje.³⁷⁹ Më 20 korrik 1711 kryeipeshkvi Zmajeviq i shkroi Kongregatës se tani nuk e ka asnjë të ri i cili do të ishte i përshtatshëm për nxënës të kolegjit Urban, porse do të mundë, nëse mësuesit e Fermos e konsiderojnë Mihill Summën si të përshtatshëm, ta dërgojë atë në kolegjin Urban.³⁸⁰ Tiberie Paccalozzi, rektor i kolegjit Ilirik të Shën Pjetrit dhe Shën Palit në Fermo, më 24 gusht 1711 i shkroi sekretarit të Kongregatës se mund të thotë me siguri se nxënësi Mihill Summa është i mirë, i zellshëm dhe më se i talentuar. Pasi që është në fillim të studimeve, nuk mund ta vlerësojë me siguri. Gjon Campsi nga ipeshkvia e Shkodrës, Tome Nekiqi nga ajo e Ninit, Gjon Calebotta nga ajo e Trogirit dhe Mihill Summa nga ipeshkvia e Sapës janë nxënës të cilët kanë predispozita për të përparuar, por tre të parët me gjithë shpirt nuk mund t'i rekomandojë sepse s'janë të qetë për nga karakteri.³⁸¹

Në vitin 1712 kryeipeshkvi Zmajeviq i raporton Kongregatës për përhapjen e fesë mbi përndjekjen e katolikëve në Bullgari dhe Serbi, ka frikë gjithashtu se do të bëhet përndjekje e tillë edhe në Shqipëri dhe për të gjithë këta e kërkon bekimin e papës.³⁸² Me këtë rast, Rusia u ndihmoi katolikëve në Shqipëri për interesa politike, ku gjithashtu ndodhën përndjekje dhe tortura. Duke i kuptuar dëshirat e rusëve kryeipeshkvi Zmajeviq shkon në Shqipëri për t'i "frenuar katolikët të cilëve u ndihmuan rusët."³⁸³ Edhe Franca për interesa politike lajmërohet si mbrojtëse e katolikëve. Të njëjtin vit, pra më 1712, ambasadori i Francës në Stamboll i përgjigjet Kongregatës për përhapjen e fesë se do të angazhohet në dobi të katolikëve në Shqipëri.³⁸⁴

Kryeipeshkvi i Tivarit, Vinko Zmajeviqi në vitin 1713 u transferua në Zarë.³⁸⁵ Po atë vit, përsëri me breve papnore u emërua i besuar apostolik për misionet në Shqipëri, Maqedoni, Serbi dhe Bullgari.³⁸⁶ Me këtë rast e fitoi edhe autorizimin për emërimin e administratorëve për kryeipeshkvinë e Tivarit, ipeshkvinë e Budvës dhe ipeshkvitë e tjera të

³⁷⁹ ASCPF, SOCG, vll. 143. ff. 583 v, 584.

³⁸⁰ ASCPF, Collegi Vari, vll. 21. f. 216.

³⁸¹ ASCPF, Collegi Vari, vll. 21. f. 123.

³⁸² ASCPF, Indice Generale, Viti 1712, Albania, Varie.

³⁸³ Po aty

³⁸⁴ Po aty

³⁸⁵ ASCPF, Indice Generale, Viti 1713, Albania, Varie.

³⁸⁶ Po aty

cilat përfshihen nën jurisdikcionin e tij prej të besuari.³⁸⁷ Për kryepeshkëv të Tivarit u emërua patër Egid Quinti (d'Armento), ish-prefekt françeskan, i cili ka qenë ipeshkëv i Sapës deri në vitin 1713.³⁸⁸ Vinko Zmajeviqi si kryepeshkëv i Zarës e kryente në mënyrë të ndërgjegjshme shërbimin e vet prej të deleguari, të cilin ia besoi papa. Është interesante përmbledhja e diskutimit të një mbledhjeje plenare të Kongregatës për përhapjen e fesë, mbajtur më 1715, e në të cilën thuhet se Vinko Zmajeviqi, ish-kryepeshkëv i Tivarit, e tani i Zarës, me letrën e 15 prillit të vitit 1715 lajmëroi se në Zarë ka arritur prefekti i misioneve françeskane në Serbi tok me tre françeskanë të tjerë, të cilët mendojnë të udhëtojnë për në Venedik. Françeskanët kanë qenë të arrestuar dhe të burgosur, kurse lirimi i tyre është paguar me 730 shkuda. Pjesa më e madhe e kësaj shume është paguar nga ndihmat e bamirësve dhe me të hollat e ndihmave të françeskanëve që ata i marrin nga Kongregata. I kanë mbetur borxh tregtarit nga Shkodra, Anton Colës, i cili shumë në fjalë e dha për lirimin e tyre, por me shpresë se do t'i kthehet me kohë. Për këtë arsye kryepeshkëvi Zmajeviq lut që tregtarit në fjalë t'i paguhet shuma e përmendur nëpër ndonjë mbivëllezëri, sepse e di se Kongregata tani nuk ka mundësi dhe nuk mund të ngarkohet me këtë shpenzim për shpengimin e françeskanëve.

Patër Dominiku nga Venediku menjëherë e ka lutur papën të paguajë shumë e përmendur, duke e njoftuar hollësisht për këtë fakt tanimë të njohur për Kongregatën dhe për brutalitetin me të cilin osmanët i kanë trajtuar misionarët. Si pasojë e këtij brutaliteti njëri vdiq. Dëshminë për borxhin ndaj tregtarit të përmendur Zmajeviqi e shton në letër së bashku me disa dokumente të tjera të cilat Kongregata ende nuk i ka parë, kurse në mesin e tyre është edhe relacioni në fjalë i patër Dominikut nga Venediku, i drejtuar papës, i cili këtë relacion ia ka dërguar për zgjidhje Kongregatës.

Franjo Bogashinoviqi, tregtar dubrovnikas (nga Novi Pazari), e njoftoi Kongregatën për burgosjen dhe torturimin e misionarëve, si dhe për vdekjen e patër Pjetër di Vicovaros (vend në rrethinë të Romës, vërejtje e autorit). Bogashinoviqi njoftoi se kanë shpëtuar vetëm dy françeskanë nga misioni i Peshterit, të cilët janë strehuar në shtëpinë e tij dhe se misionarët e kanë shkaktuar vetë përndjekjen me vendimin për të ecur në veshje rregulltare nëpër ato vise ku françeskanët janë konsideruar spiunë.

Të gjitha këto i vërtetoi patër Rafaeli nga Napoli, njëri prej françeskanëve i cili është strehuar në shtëpinë e Bogashinoviqit, duke

³⁸⁷ Po aty

³⁸⁸ Po aty

shtuar se katolikët në Pejë, ku françeskanët e arrestuar kanë qenë të burgosur, ua kanë paguar osmanëve 800 shkuda për t'i liruar françeskanët, por e kanë arritur vetëm atë që t'u hiqen prangat, kurse françeskanët edhe më tutje kanë mbetur të burgosur.

Egidi Quinto, kryeipeshkvi i zgjedhur i Tivarit i shkroi atit prokurator të misioneve françeskane se pashai i Pejës i ka obliguar me betim françeskanët e burgosur që mos t'ia zbulojnë askujt të gjitha përjetimet e tyre, duke i obliguar edhe katolikët në Pejë dhe Gjakovë të paguajnë edhe deri në një mijë dukatë në rast se misionarët zbulojnë se si janë trajtuar. Kryeipeshkvi Quinto e shkroi lutjen në të cilën i raportoi mbi të gjitha oborrit të Vjenës nëpërmes ambasadorit perandorak në Romë, me qëllim dënimi të drejtë të pashait të përmendur si pasha, i cili e ka cenuar dhe shkelur marrëveshjen me papën. Sekretariati i shtetit të Vatikanit i njoftoi për rastin zëdhënësit perandorakë, zëdhënësit e mbretit francez në Stamboll, dhe nuncët papnorë në Vjenë.

Patër Luigjit nga Valmadere, prefekt i misioneve françeskane në Maqedoni me letrën e 27 majit të shkuar, njoftoi për përndjekjet e misionarëve të atjeshëm, të përcjellë me plaçkitjen dhe rrënimin e misioneve dhe për borxhin, të cilin e kanë marrë katolikët e varfër të vendit, për t'i liruar misionarët nga burgu. Ndihmë kërkuan nga konsulli francez në Durrës, i cili ndërhyri te komandanti kryesor i ushtrisë osmane në atë krahinë. Konsulli arriti që pashait në Serbi t'i jepet urdhër t'i kthejë gjërat dhe të hollat e rrëmbyera nga misionarët, sepse ata janë nën mbrojtjen e mbretit francez. Ky intervenim i kushtoi konsullit 22 cekinë, të cilët janë shpenzuar për blerjen e dhuratave të ndryshme për komandantin kryesor të lartpërmendur. Kongregatës i bëhet lutje që t'ia kompensojë konsullit të hollat e shpenzuara, kurse kryeipeshkvit Zmajeviq i është urdhëruar lidhur me këtë qëllim. Në lidhje me këtë ati prokurator i misioneve françeskane bëri lutje që Kongregata të kujdesohet që ambasadori francez në Stamboll të përcjellë dëftesën e vërtetuar zyrtarisht me të cilën do të dëshmonte se Prefekurat françeskane të Shqipërisë, Serbisë dhe Maqedonisë, së bashku me misionarët e tyre, janë nën mbrojtjen e mbretit francez. Kongregata e bëri këtë, duke i shkruar kardinalit de la Tremoylle, i cili për këtë i shkroi zëdhënësit të mbretit francez në Stamboll, Marchioni de Alleurs-it dhe konsujve. Patër Antoni nga Monte Mura, misionar në Serbi, gjithashtu e njofton Kongregatën mbi përndjekjen e misionarëve dhe rrënimin e të gjitha misioneve të atjeshme përveç atij në Peshter, ku ndodhet ai, e të cilin nga shkatërrimi i plotë e ruajtën katolikët e atjeshëm, Klementinët, duke e bërë pagesën prej 30 cekinëve dhe me kusht që rastin e lirimit të misionarëve të tyre t'ua lënë në vullnet osmanëve, për çka u detyruan edhe ta japin besën. Patër Antoni, sipas urdhrit të prefektit, ndenji i

vetëm në Serbi, kurse françeskanët e tjerë u strehuan tek tregtarët dubrovnikas në Novi Pazar. Patër Antoni e shkroi edhe lutjen që t'i dërgohet një françeskan që e njuh gjuhën shqipe dhe luti që t'i përgjigjet, a të rrijë në Serbi, apo të kthehet në Itali. Katolikët në Serbi janë të shumtë dhe është e nevojshme që t'u ndihmohet, prandaj t'u dërgohen misionarë. Lut që Kongregata të kujdeset për rindërtimin dhe rithemelimin e misioneve në Serbi, e që këto misione të vihen nën mbrojtjen e ndonjë mbreti, i cili është në armëpushim me osmanët dhe do të mundë të fitojë fermanin për kthimin e misionarëve në ato misione, me vërejtje që të veshin rroba që vishen në ato vise, sepse petku françeskan bie tepër në sy.

Sa i përket mbrojtjes, Kongregata e ka shprehur posaçërisht mendimin e vet kur iu drejtua kardinalit de la Tremoyelle, kurse sa u përket rrobave shekullare, në autorizimet që u jepen misionarëve, nën numrin 21 thuhet: Le të vishen në rroba shekullare, po edhe atëherë kur bëhet fjalë për rregulltarë, nëse ndryshe nuk mund të ecin, të rrinë në vendet në të cilat janë misionet në fjalë. Kjo gjë theksohet sepse françeskanët e reformuar në ato vise nuk kanë vepruar kështu. Përveç kësaj, rekomandohet që para së gjithash është e nevojshme që një konsull i të njëjtit sovran të rezidojë në Pejë, e cila është kryeqyteti i Serbisë. Ky konsull në kohën e volitshme do të kujdesej që t'i shpëtojë të gjithë ato shpirtra nga rreziku i shkëputjes nga feja katolike, pasi që mendohet se pa konsullin në fjalë, të gjitha përpjekjet do të ishin të kota.

Në fund, aty gjendet edhe lutja që fra Umile nga Terranova të kthehet në fenë katolike, të cilës i ra mohit. Ky vëlla laik françeskan është përnduar për gabimin e vet dhe dëshiron t'i kthehet grigjës, afër së cilës edhe gjendet. Sekretari i Kongregatës i njofton kardinalët se ish kryeipeshkvi i Tivarit dhe kryeipeshkvi i tanishëm i Zarës, në vizitë in e bërë misioneve në Shqipëri, për të cilin vizitë në Kongregatë është diskutuar në vitin 1704, ka thënë se fra Umile i lartpërmendur nuk është sjellë mirë dhe se për këtë arsye është urdhëruar që të largohet nga misionet, kurse në vitin 1705 Zmajeviqi njoftoi se ky françeskan i ka ra mohit fesë katolike dhe ka kaluar në islam.³⁸⁹

Mbi këtë përndjekje të françeskanëve, kryeipeshkvi i Shkupit, Pjetër Karagiqi e njoftoi Kongregatën për përhapjen e fesë dhe Kongregatën e Koncilit, në raportin mbi vizitë in kanonik të kryeipeshkvisë, të shkruar më 12 qershor 1716. Në atë raport kryeipeshkvi thotë: "Në qytetin e Pejës dhe në shumë fshatra përreth, prej të cilave disa janë edhe tre ditë ecje këmbë larg nga Peja, gjer tani kanë banuar dy etër misionarë me ndihmë prej 12 cekinësh nga e

³⁸⁹ ASCPF, SOCG, vll. 600, ff. 375 N., 376 rv, 377rv, 378rv, 379.

Shenjta Kongregatë për përhapjen e fesë. Tash atje nuk është asnjë atë, e as prift shekullar pasi që me fillimin e luftës së Moresë, sipas urdhrit të Turkut të madh është dashur të vritet secili që është nga Italia ose Venediku (Republika e Venedikut, vërejtje e autorit), goftë ai laik ose rregulltar, nëse për 24 ditë nuk shkon në vendlindjen e vet. Ali pasha nga Peja nuk veproi kështu, por i arrestoi etërit misionarë dhe ata tre nga Peja, dy nga Zoganje, dy nga Rugova dhe dy nga Cernagora (Letnica), duke marrë gjithçka që ka gjetur në hospicium: të gjitha mobilet, kelqet, patenat, piksidet, deri gjilpërat për qepje dhe pullat. Ata u lidhën në pranga dhe me mendjemadhësinë më të madhe janë munduar me mundimet më të këqija, kurse për t'ua shpëtuar jetën, është dashur të jepen 700 imperiala. I Ajori, ati Pjetër Romano (di Vicavaro) vdiq në ato mundime për fenë e Krishtit. Edhe unë kam ikur në atë kohë të përndjekjeve, që mos të më shti në dorë pashai, e pasi që dimri ka qenë shumë i ftohtë, kurse unë plak, nga frika u sëmura, dhe m'u bë se m'u ngjall diçka në lukth, kështu që katërmbëdhjetë muaj i kalova në shtrat, sot i gjallë e nesër vdekur, e tani jam më mirë dhe Zotit të madh i falem edhe pse jam dobësuar. Në famullinë e Pejës janë 2000 katolikë. Tani për tani pashai nuk e lejon asnjë françeskan që t'i vizitojë fshatrat e famullisë së Pejës, mbi të cilat ai e ka pushtetin, veçse zëvendësi i tij i ka premtuar misionarit nga Hasi, don Markut (Bianchi), se do të mund të vinte vetëm në Pejë, kurse e ka përmendur edhe shkasin, duke thënë se ata e dinë se kush janë katolikët dhe se ne, ç'është e vërteta, do ta gjejmë një zëvendës të fshehtë dhe të denjë. Në Kosovë, Drenicë dhe Çiçavicë do të shkojë, siç ka përcaktuar tash, don Gjon Prença, misionari nga Janjeva, i cili do t'i vizitojë besimtarët dhe do t'ua ndajë sakramentet, gjersa nuk gjendet misionar".³⁹⁰

"Në qytetin e Gjakovës dhe në fshatra kanë qenë dy etër misionarë dhe i treti ka qenë mjek françeskan, kurse kanë banuar në fshatin Zoganje me ndihmë prej 12 cekinësh nga e Shenjta Kongregatë. Aty janë 2000 katolikë. Në asnjë vend nuk ka kishë. Mesha çohet në shtëpi. Tash vonë ka ardhur një prift nga ipeshkvia e Sapës në vend të etërve, banon në Zoganje me frikë të madhe dhe në rrezik e viziton Gjakovën dhe fshatrat përreth. Në korrik do të bëhet një vit prejse i kam lutur shkëlqesinë Tuaj për këtë prift dhe prejse ia keni caktuar ato 10 shkuda, kështu që ky nuk do të kthehej në vendlindje, po qe se nuk do t'i fitonte."³⁹¹

"Në fshatrat e Peshterit, në të cilat banojnë Klementinët, kanë qenë katër etër misionarë me ndihmë prej 40 shkudash nga e Shenjta

³⁹⁰ Asv, S. Congr. Cincilli, Relationes, Scapien., VII 728, Visita 1716.

³⁹¹ Po aty

Kongregatë për përhapjen e fesë. Në kohën e përndjekjeve të françeskanëve këta u mblodhën në Novi Pazar. E për atë arsye se njëri prej tyre shkoi ta marrë përsipër atë që ka mbetur ndër Klementinë atëherë i dhuruan pashait 89 imperialë, që etërit të mbesin edhe më tutje në Peshter. Pashai e dha lejen, por dy etër gjermanë (austriakë) nuk deshën të shkojnë atje, por ikën në Gjermani (Austri). Veçse ka mbetur patër Antoni nga Monte Fortino (Monte Muro) dhe ai i viziton besimtarët nëpër fshatra dhe i ndan sakramentet në të gjitha fshatrat. Aty janë 2000 katolikë. Nuk kanë kishë. Meshohet nëpër shtëpi.”³⁹²

“Në fshatin Rugovë dhe në Plavë, e në fshatrat e tjera që u përkasin këtyre krahinave kanë qenë dy etër misionarë me ndihmë prej 25 shkudash nga e Shenjta Kongregatë për përhapjen e fesë. Aty janë 600 katolikë. Pashai nuk e lejon asnjë prift që t'i vizitojë besimtarët dhe t'i ndajë sakramentet. Zoti le të gjykojë lidhur me këtë.”³⁹³

Pas kësaj përndjekjeje të françeskanëve nga kryeipeshkvia e Shkupit, u emëruan misionarët e rinj françeskanë, të cilët tashmë janë nisur për në vendet e tyre, por Kongregata më 1715 ua dha lejen të kthehen në provincën e tyre, sepse pushteti nuk e lejoi ardhjen në misionet e asaj province.³⁹⁴ Kongregata u urdhëroi të kthehen në provincën e tyre, e jo të vijnë në Romë.³⁹⁵ Ish prefekti i misioneve në Serbi, erdhi në Ankonë më 1715. Me të njëjtën anije erdhën edhe robërit që i zunë ulqinakët të cilët janë vendosur në Senigalgi dhe Recanati.³⁹⁶ Etërit Jakob di Cisterna dhe Rrok da Cosale, të cilët janë përndjekur nga Serbia, lusin që t'u lejohet të vijnë në Romë.³⁹⁷ Kryeipeshkvi Zmajeviq propozon që të ndërrohet prefekti françeskan në Serbi.³⁹⁸ Të njëjtin vit, pra më 1715 Zmajeviqi i rekomandon Kongregatës që të kthehen në provincat e tyre misionarët që kanë ikur nga misionet e veta, e gjithashtu edhe ata që nuk mund të hyjnë në misione.³⁹⁹ Atë vit Pentitenciar i dha dispensën për faljen e fra Umilos nga Terranova, vëllait laik françeskan, i cili kishte kaluar në islam, e pastaj ishte penduar.⁴⁰⁰ Kryeipeshkvi i Zarës, Zmajeviqi e delegoi patër Anton da Monte Muron, që ta lirojë nga mëkati.⁴⁰¹ Patër Anton da Monte Muro u emërua prefekt në Serbi, kurse me të do të jenë vetëm edhe dy misionarë.⁴⁰² Patër Jozefi nga Pedana, i

³⁹² Po aty

³⁹³ Po aty

³⁹⁴ ASCPF, Indice Generale, Viti 1715, SERVIA, Regolari.

³⁹⁵ Po aty

³⁹⁶ Po aty

³⁹⁷ Po aty

³⁹⁸ Po aty

³⁹⁹ Po aty

⁴⁰⁰ Po aty

⁴⁰¹ Po aty

⁴⁰² Po aty

cili është caktuar misionar në Serbi, më 1716, i kërkon nga Kongregata disa objekte liturgjike dhe libra,⁴⁰³ kurse në vitin 1715 i bëri lutje Kongregatës që t'u rekomandojë krerëve të tij që ta pajisin me rroba, sepse është caktuar misionar në Serbi.⁴⁰⁴ Në vend të françeskanëve, në Zoganje vjen don Jakob Kabashi, të cilin kryeipeshkvi Karagiq e solli nga Shqipëria në marrëveshje me Zmajeviqin.⁴⁰⁵ Kryeipeshkvia e Shkupit, përsëri kishte fare pak priftërinj shekullarë. Për këtë arsye, kryeipeshkvi Karagiq më 1716 kërroi nga Kongregata dispENZën prej moshës së nevojshme për shugurim priftëror të dy teologëve të cilët i kishin nga 22 vjet.⁴⁰⁶ Karagiq, në vitin 1716 e njofton Kongregatën për situatën e rëndë në kryeipeshkvinë e tij dhe për varfërinë në të cilën gjendej për shkak të shpenzimeve të mëdha. Nga ndihma të cilën e merrte nga Kongregata, këtij i mbeteshin vetëm dy të tretat. Kishat e rrënuara nuk mund të rindërtoheshin. Për shkak të shkuarjes së etërve françeskanë katolikët e atjeshëm kishin mbetur pa priftërinj. Kërkon ndihmë për priftin nga ipeshkvia e Sapës (don Jakob Kabashin), të cilin e ka caktuar në Gjakovë dhe fshatrat përreth. Përpiqet që në Peshter të vjen ndonjë françeskan tjetër nga Shqipëria, por i veshur sipas zakoneve të vendit, pa mjekër dhe që e njuh gjuhën shqipe.⁴⁰⁷

Në vitin 1717, kryeipeshkvi Zmajeviq i propozon Kongregatës, që tregtarin dubrovnikas në Novi Pazar, Franjo Bogashinoviçin ta emërojë mbikëqyrës të misioneve në Serbi.⁴⁰⁸ Po atë vit Kongregata i dërgon kryeipeshkvit Zmajeviq ndihmat për misionarët në kryeipeshkvinë e Shkupit por vetëm për ata që janë në mision, të cilët për këtë punë do t'i dërgojnë edhe dëftesat. Nëse misionarët në fjalë nuk janë në misionet e tyre, të hollat le t'i kthehen Kongregatës.⁴⁰⁹

Kur u qetësua pak situata, françeskanët përsëri filluan të kthehen në kryeipeshkvinë e Shkupit. Ati prokurator i misioneve françeskane e njofton Kongregatën se patër Jakob da Cisterna është i pikëlluar, pasi që për shkak të supozimit se është i sëmurë, nuk do të kthehet në Misionin e Serbisë. Emërohen françeskanët e tjerë, ish nxënësit e kolegjit misionarik françeskan të Shën Pjetër Montorios në Romë.⁴¹⁰ Pater Karl da Monte Fortino bëri lutje që të dërgohet përsëri misionar në Serbi së bashku me

⁴⁰³ ASCPF, Indice Generale, Viti 1716. Servia

⁴⁰⁴ ASCPF, Indice Generale, Viti 1715. Servia, Regolari

⁴⁰⁵ ASCPF, Indice Generale, Viti 1716. Servia.

⁴⁰⁶ Po aty

⁴⁰⁷ Po aty

⁴⁰⁸ ASCPF, Indice Generale, Viti 1717, Servia.

⁴⁰⁹ Po aty

⁴¹⁰ Po aty

sivëllezërit e tjerë.⁴¹¹ Patër Tomë da Monte Muro bëri lutje për të njëjtën gjë.⁴¹²

Në vitin 1718 Kongregata e emëroi Franjo Bogashinoviçin, për meritat e tij, mbikëqyrës dhe mbrojtës të misioneve françeskanë në Serbi dhe në "Peshter".⁴¹³ Po këtë vit prefekti françeskan nga Prefektura e Serbisë kërkon nga Kongregata që të angazhohet te Oborri i Vjenës që ushtria perandorake mos t'i dëmtojë katolikët dhe misionarët e atjeshëm.⁴¹⁴ Patër Venancio da Pentima nga Shqipëria udhëtoi për në Itali. Kryeipeshkvi i Zarës, Zmajeviqi i rekomandoi Kongregatës që ta lirojë nga dënimi të cilin e ka marrë për shkak të gabimeve të tij.⁴¹⁵ I njëjti patër e njofton Kongregatën për ardhjen e tij në Ankonë, ku i pret urdhrat e reja të Kongregatës. Përsëri e rekomandon kryeipeshkvi i Zarës.⁴¹⁶

Patër Fedelle della Posta, misionar në Maqedoni, në vitin 1719 kërkonte leje për të shkuar për shërbim në Serbi, ku ka qëndruar shumë herë sipas dekretit të Kongregatës.⁴¹⁷ Prefekti françeskan në kryeipeshkvinë e Shkupit, më 1719 kërkonte nga Kongregata që t'i dërgojë atje katër françeskanë që merren me mjekim e kirurgji dhe lutet që Kongregata t'i furnizojë me instrumente për mjekim dhe objekte liturgjike. Me ardhjen e këtyre françeskanëve dëshirohet që përsëri të hapen misionet në Pejë dhe Zoganje, e në atë rast do të ishin të nevojshme edhe hospiciumet në këto misione.⁴¹⁸ Kongregata përpigëj që t'ia plotësojë prefektit kërkesën dhe caktoi patër Pjetër di Medicinën për misionar në kryeipeshkvinë e Shkupit. I njëjti ky patër i fitoi edhe ofiqet për praktikim të mjekimit dhe të kirurgjisë.⁴¹⁹ Patër Anton da Monte Muro, prefekt në Serbi, të cilin e lavdëroi kryeipeshkvi i Zarës, në vitin 1719 u ankua se prokuratori i misioneve nuk i dërgonte ndihmat misionarike.⁴²⁰ Patër Zefi nga Pedana, misionar serb, i lavdëruar nga kryeipeshkvi i Zarës, nuk mund të marrë rroba, sepse nuk është anëtar i asnjë province. I rekomandohet kardinalit protektor të rendit françeskan, kështu që ky të urdhërojë që t'i jepen rrobat.⁴²¹ Prokuratori i

⁴¹¹ Po aty

⁴¹² Po aty

⁴¹³ ASCPF, Indice Generale, Viti 1718, Servia.

⁴¹⁴ Po aty

⁴¹⁵ Po aty

⁴¹⁶ Po aty

⁴¹⁷ ASCPF, Indice Generale, Viti 1719, Servia.

⁴¹⁸ Po aty

⁴¹⁹ Po aty

⁴²⁰ Po aty

⁴²¹ Po aty

misioneve françeskane kërkon të holla nga Kongregata për shpenzimet e udhëtimit të misionarëve të caktuar për Prefekturën e Serbisë.⁴²²

Në fillim të vitit 1720, përsëri filloi përndjekja e françeskanëve, kështu që propozohet që në Serbi të dërgohen misionarët françeskanë që janë të aftë për mjekim dhe kirurgji, madje edhe me “përdjegje”, sepse osmanët për shkak të tyre do t'i mbrojnë edhe françeskanët e tjerë.⁴²³ Në vitin 1720 Kongregata pagoi 22 cekinë, të cilët ati prefekt i Maqedonisë i huazoi nga konsulli francez në Durrës për t'i shpenguar rregulltarët në Serbi, të cilët i burgosën osmanët dhe për t'i mbrojtur rregulltarët e tjerë në Maqedoni dhe në Shqipëri.⁴²⁴ Patër Pjetër di Medicina, i cili qe caktuar misionar në Serbi, u revokua më 1720 në provincën e vet, sepse derisa qe në vendlindje “Rregulli i tij nuk ka mundur të mburret me të.”⁴²⁵ Po atë vit, Kongregata u shkruan ministrave të sovranëve katolikë, të cilët qëndronin në Portë, që t'i mbrojnë misionarët dhe katolikët në Serbi.⁴²⁶ Etërit Bernardino di Cerrano, Karlo di Caprino dhe Ludovik di Taranto u propozuan më 1720 për misionarë në Prefekturën e Serbisë.⁴²⁷ Patër Anton di Monte Muros i skadoi afati i detyrës së prefektit, kështu që më 1720 patër Karl di Caprino u emërua prefekt.⁴²⁸ Kryeipeshkvi Zmajeviq nuk u pajtua me propozimin që të shkojë në misionet patër Ludovik di Taranto.⁴²⁹

Pa lejen e kryeipeshkvit Zmajeviq si i deleguar i Kongregatës për misionet dhe misionarët, asnjë misionar nuk ka mundur të kalojë nga njëra prefekturë në tjetrën. Kështu më 1721, me lejen e kryeipeshkvit Zmajeviq, pater Metod Pazaurech kaloi nga Prefektura e Maqedonisë në Prefekturën e Serbisë për shkaqe shëndetësore, kurse Kongregata e miratoi këtë vendim të Zmajeviqit.⁴³⁰ Osmanët i dëbuan françeskanët nga misioni i Cernagorës (Letnicës). Ipeshkvi i Lezhës arriti ta marrë lejen nga pushteti që të dërgojë atje disa herë në vit famullitarin nga Fandi, kurse këtij famullitari ia caktoi ndihmësin për të cilin më 1721 kërkoj ndihmë nga Kongregata.⁴³¹

Prefekti i françeskanëve në Serbi, në vitin 1722 e ripërtëriu misionin në Rugovë, u përpoq gjithashtu t'i ripërtërijë edhe misionet e tjera françeskane.⁴³² Me propozimin e kryeipeshkvit Zmajeviq, don Gjon

⁴²² Po aty

⁴²³ ASCPF, Indice Generale, Viti 1720, Servia.

⁴²⁴ Po aty

⁴²⁵ Po aty

⁴²⁶ Po aty

⁴²⁷ Po aty

⁴²⁸ Po aty

⁴²⁹ Po aty

⁴³⁰ ASCPF, Indice Generale, Viti 1721. Servia.

⁴³¹ Po aty

⁴³² ASCPF, Indice Generale, Viti 1722, Servia.

Prenga, famullitar në Janjevë dhe vikar gjeneral i kryeipeshkvit të Shkupit, u zgjodh ipeshkëv i Nikopolit në Bullgari.⁴³³ Pas përfundimit të detyrës së prefektit, patër Anton da Monte Muro mbeti në Prefekturën e Serbisë si misionar i thjeshtë. Në vitin 1722 Kongregata shënoi se patër Antoni, ish prefekt i françeskanëve observantë të reformuar në Serbi, e themeloi hospiciumin në Rugovë, pasi që nga pashai e mori lejen që misionarët të banojnë në këto dhe vendet e tjera, në të cilat kanë banuar para luftës.⁴³⁴

Mirëpo, françeskanët nuk mundën të kthehen në Pejë dhe në Zoganje e Gjakovë. Atje, Kongregata në marrëveshje me kryeipeshkvin Zmajeviq dhe kryeipeshkvin Karagiq, i emëroi famullitarë priftërinjtë shekullarë dhe don Gjergj Jovanoviqin në Gjakovë dhe Zoganje e don Andrej Bracianin në Pejë, të cilëve ua caktoi ndihmën prej 25 shkudash në vit.⁴³⁵ Kështu, françeskanët prej tash nuk kanë mision tjetër të përhershëm përveç në Peshter, kurse misioni kishte nevojë për tre ose katër misionarë.⁴³⁶ Misioni në Rugovë nuk qe i përhershëm.⁴³⁷ Franjo Bogashinoviç, mbikëqyrës dhe mbrojtës i misioneve në Serbi nuk e miraton zellin e madh të patër Anton da Monte Muros në përpjekjet e tij tek pashai për ripërtëritjen e misioneve të mëparshme.⁴³⁸ Në vitin 1723 Françeskanët i ankohen Kongregatës se Franjo Bogashinoviç shërbehet me “dorën turke” për interesat e tij personale, duke i ngarkuar etërit misionarë. Kryeipeshkvi Zmajeviq ia tërheq vërejtjen Bogashinoviçit dhe i rregullon gjërat.⁴³⁹ Edhe pse françeskanët nuk qenë ende të vendosur përgjithmonë në Rugovë, ata kryenin atje shërbimin misionarik dhe famullitar, kështu në vitin 1723, ia dërguan Kongregatës relacionin për veprimtarinë e tyre në këtë famulli.⁴⁴⁰

Siç e kemi përmendur më parë, pushteti osman e kishte ndaluar qëndrimin e përhershëm të misionarëve në Cernagora (Letnica). Kryeipeshkvi Zmajeviq, më 8 mars 1724 i shkroi nga Zara Kongregatës për përhapjen e fesë, se shërbimi i famullitarit në Cernagora duhet t'i besohet famullitarit në Fandë me ndihmën e cila do t'i merrej famullitarit të Dibrës, sepse kjo famulli është mjaft e pasur. Kështu, Kongregata do ta zgjidhë këtë çështje pa shpenzime të reja.⁴⁴¹

⁴³³ Po aty

⁴³⁴ Po aty

⁴³⁵ Po aty

⁴³⁶ Po aty

⁴³⁷ Po aty

⁴³⁸ Po aty

⁴³⁹ ASCPF, Indice Generale, Viti 1723, Servia.

⁴⁴⁰ Po aty

⁴⁴¹ ASCPF, SOCG, VII. 576. f. 60.

Më 10 mars 1724 kryeipeshkvi Zmajeviq i bën lutje Kongregatës që t'ia shtojë ndihmën vjetore don Mihill Summës, misionarit në Janjevë, që të mund ta mbajë veten dhe ndihmësin e vet.⁴⁴² Më 1 gusht 1724 Zmajeviqi i shkruan Kongregatës se do të ishte mirë që don Mihill Summa, i cili për shkak të virtyteve të veta, merrte ndihmën prej 20 shkudash si famullitar në Zadanje, të njëjtën shumë ta marrë edhe si famullitar në Janjevë.⁴⁴³ Kongregata vendosi që me ndihmën që cilën Summa e merrte në Zadanje, ta mbajë ndihmësin e tij.⁴⁴⁴ Në vitin 1724 françeskanët e njoftojnë Kongregatën për veprimtarinë e tyre në Peshter dhe Rugovë dhe bëjnë lutje që të caktohen misionarët e përhershëm për Rugovë dhe t'u jepen ndihmat.⁴⁴⁵

Prefekti françeskan, më 1725, e njoftoi Kongregatën për misionin e rithemeluar në Rugovë, për qëndrimin e përhershëm të misionarëve të rinj në atë mision dhe për nevojën e pagesës së ndihmave të ardhura për misionarët e tij françeskanë.⁴⁴⁶

Don Gjon Prençi, ipeshkvi i zgjedhur i Nikopolit, u sëmur prandaj as që u shugurua ipeshkëv i Nikopolit. Vdiq në vitin 1726, kur vdiq edhe don Nikollë Vishçiqi, misionar në Shkup.⁴⁴⁷ Atë vit edhe patër Frana nga Milano u emërua prefekt në Prefekturën e Serbisë, në vend të patër Karl di Caprinos.⁴⁴⁸ Kryeipeshkvi i Shkupit, Pjetër Karagiqi, më 30 prill 1726, e njofton Kongregatën për përhapjen e fesë se është sëmure rënd dhe se beson se do të vdesë së shpejti. I sistemon të hollat e ndihmës së tij e cila nuk i ishte paguar: 100 shkuda i jep për meshë testamentale, kurse 100 shkuda për mesha të thjeshta të cilat do të bëhen për shpirtin e tij.⁴⁴⁹

Don Pal Vakanji, rrëfyestari dhe testatori i kryeipeshkvit Karagiq, më 24 shkurt 1727, nga Zymi e njofton Kongregatën se kryeipeshkvi Pjetër Karagiq ka vdekur më 15 janar 1727 dhe se para vdekjes e ka bërë testamentin.⁴⁵⁰ Në një fletë të veçantë, e cilën nuk mban datë, don Pali shënon se kujt i ka dhënë të holla sipas testamentit të kryeipeshkvit dhe cilat borxhe të kryeipeshkvit i duhet ende t'i paguajë.⁴⁵¹ Juraj Jurjeviqi, përfaqësuesi i kryeipeshkvit Karagiq në Romë, në letrën e 21 korrikut të vitit 1727 e pyet Kongregatën se a të veprojnë me 200 shkudat që kanë mbetur te ky pas vdekjes së kryeipeshkvit siç e ka lënë kryeipeshkvi

⁴⁴² ASCPF, SOCG, VII. 576, f. 54.rv.

⁴⁴³ 124 ASCPF, SOCG, VII. 645, f. 57.

⁴⁴⁴ ASCPF, Indice Generale, Viti 1724, Servi.

⁴⁴⁵ Po aty

⁴⁴⁶ ASCPF, Indice Generale, Viti 1725, Servia.

⁴⁴⁷ ASCPF, Indice Generale, Viti 1726, Servia.

⁴⁴⁸ Po aty

⁴⁴⁹ ASCPF, SOCG, VII. 657, f. 52.

⁴⁵⁰ ASCPF, SOCG, VII. 667, f. 62.

⁴⁵¹ ASCPF, SOCG, VII. 667, f. 64.

Karagiq me testament ose duhet të veprohet ndryshe.⁴⁵² Kongregata i përgjigjet se vullneti i kryeipeshkvit duhet plotësuar.⁴⁵³

Pas vdekjes së Karagiqit duhej zgjedhur kryeipeshkvi i ri i Shkupit. Kandidatë qenë don Mihill Summa, famullitar në Janjevë, patër Serafini nga Alzano, françeskan opservant dhe patër Gjon Franë Bossi, françeskan konventual. Patër Serafini tashmë i kishte siguruar dëftesat e nevojshme.⁴⁵⁴ Kongregata për përhapjen e fesë e njoftoi kryeipeshkvin e Zarës, Vinko Zmajeviq për kandidaturën e patër Serafinin dhe se janë emëruar kardinalët të cilët do të merren me këtë dhe se për patër Serafinin kanë arritur dëftesat e nevojshme.⁴⁵⁵ Kryeipeshkvi Zmajeviq, më 16 maj 1727, ia propozon Kongregatës për përhapjen e fesë don Mihill Summen si kandidat më të përshtatshëm për shërbimin e kryeipeshkvit të Shkupit.⁴⁵⁶ Më 7 qershor 1727, Zmajeviqi i shkruan përfaqësuesit të vet dhe të kryeipeshkvisë së Shkupit në Romë, Juraj Jurjeviqit, se është i papranueshëm vonimi i emërimit dhe kërkimi i trashëgimtarit të kryeipeshkvit të ndjerë Karagiqit, sepse don Mihill Summa i plotëson të gjitha kushtet për këtë emërim.⁴⁵⁷ Mbi emërimin e kryeipeshkvit të ri të Shkupit, Kongregata diskutoi më 21 korrik 1727. Në mbledhje u shënua se kryeipeshkvi i Zarës, Vinko Zmajeviq, e rekomandon don Mihill Summën si kandidat më të aftë për kryeipeshkv të Shkupit.⁴⁵⁸ Me 21 gusht 1727, në pallatin e Kvirinalit, papa vendosi që kryeipeshkëv i Shkupit të jetë don Mihill Summa.⁴⁵⁹

Me letrën e 8 korrikut 1729 kryeipeshkvi Mihill Summa i falënderohet Kongregatës për përhapjen e fesë, për të gjitha çka ka bërë për të prej shkollimit në kolegjin e Fermos, në të cilin është pranuar sipas lutjes së imzotit Zmajeviq, deri në emërimin për kryeipeshkëv të Shkupit.⁴⁶⁰ Qysh në vitin 1728, Kongregata i merr ankesat për prefektin françeskan në Serbi. Ky u akuzua për administrim të keq të Prefekturës.⁴⁶¹ Këto ankesa dhe akuza përsëriten në vitin 1729, por kryeipeshkvi Zmajeviq e mbron patër Franën nga Milano, i cili atëherë ishte prefekt. Patër Frana shkon në Romë, e Kongregata e merr në pyetje dhe e heton. Prefekti përgjigjet ndaj akuzave,⁴⁶² kurse në vitin 1730,

⁴⁵² ASCPF, SOCG, VII. 657, f. 51.

⁴⁵³ ASCPF, Indice Generale, Viti 1727, Servia.

⁴⁵⁴ ASCPF, SOCG, vll. 657, ff. 55, 58 rv, 57, 59.

⁴⁵⁵ ASCPF, SOCG, vll. 657, f. 61 rv.

⁴⁵⁶ ASCPF, SOCG, vll. 657, f. 53 rv.

⁴⁵⁷ ASCPF, SOCG, vll. 657, f. 54.

⁴⁵⁸ ASCPF, ACTA, vll. 97. Është shqyrtuar 21. VII. 1727.

⁴⁵⁹ ASCPF, SOCG, vll. 657, f. 62.

⁴⁶⁰ ASCPF, SOCG., vll. 665, f. 158. 1.

⁴⁶¹ ASCPP, Indice Generale, Viti 1728, Servia, Regolari, Varie.

⁴⁶² ASCPF, Indice Generale, Viti 1729, Servia, Regolari, Varie.

Kongregata e liron nga akuzat patër Franën dhe e lejon të kthehet në Prefekturën e vet.⁴⁶³

Në vitin 1730 kryeipeshkvi Summa i bëri lutje Kongregatës që t'i japë ndihma për riparimin e kishave dhe ndërtimin e banesave misionarike në kryeipeshkvinë e Shkupit.⁴⁶⁴ Me letrën e 8 janarit të vitit 1731, kryeipeshkvi Zmajeviq e njoftoi Kongregatën se për shkak të afërsisë së kufirit me Perandorinë Austriake dhe të telasheve që mund të lindin, do të ishte më së miri që kishat në Janjevë dhe Cernagora (Letnica) të riparohen vetëm aq sa është më se e nevojshme dhe se për këto punime do të ishin të nevojshme vetëm 50 shkuda. Kishat e tjera, të cilat janë pak më të fshehura dhe më larg nga udhët, do të mund të riparoheshin krejtësisht, sepse këto vise janë përplot me material ndërtimor, i cili mund të gjendet shumë lirë.⁴⁶⁵ Në lutjen dërguar Kongregatës më 20 korrik 1731, kryeipeshkvi Summa njofton se për punimet në Shkup nevojiten 60 shkuda, kurse në Pejë 40 shkuda. Për banesat famullitare në Zym dhe Janjevë janë të nevojshme 160 shkuda. Me ndërtimin e banesave do të arrihej që priftërinjtë mos të banojnë te laikët dhe ashtu do të evitoheshin telashtet e ndryshme.⁴⁶⁶ Në mbledhjen e Kongregatës, të mbajtur më 4 shtator 1731, është thënë se kryeipeshkvi i Shkupit, Mihill Summa, ka kërkuar ndihmë për riparimin e kishave në kryeipeshkvinë e tij. Pasi që shpenzimet do të ishin të mëdha, sepse kishat janë tepër të dëmtuara, duhet të merrte edhe lejen e pushtetit për këto riparime. Kryeipeshkvi Summa, gjithashtu ka bërë lutje edhe për rindërtimin e ndërtesave të famullive. Kongregata i shkroi Vinko Zmajeviqit, kryeipeshkvit të Zarës, e ky përgjigjet se për këto punime duhet pritur kohë më të mira. Sa u përket ndërtesave të famullive, Zmajeviqi përgjigjet se kjo do ta rëndonte shumë Kongregatën e cila tani gjendet në varfëri. Kongregata e "mori parasysh" mendimin e kryeipeshkvit.⁴⁶⁷

Më 26 shtator 1733, kryeipeshkvi Summa e njoftoi sekretarin e Kongregatës për përhapjen e fesë për letrat që i ka marrë dhe e falënderon për ndihmën prej 10 shkudash, të cilën Kongregata ia ka dërguar don Pjetër Batucit. E kupton varfërinë e Kongregatës, por përsërit se rindërtimi i godinave të famullive është i nevojshëm që populli të ketë ku të mblidhet për meshë, por edhe për faktin se nuk është e përshtatshme që priftërinjtë të banojnë në shtëpitë e laikëve.⁴⁶⁸

⁴⁶³ ASCPF, Indice generale, Viti 1730, Servia, Regolari, Varie.

⁴⁶⁴ ASCPF, Indice Generale, Viti 1730, Servia, Arcivescovo, Parochi, Missionari.

⁴⁶⁵ ASCPF, SOCG, vll. 670, f. 43. rv.

⁴⁶⁶ ASCPF, SOCG, vll. 677, f. 296. rv.

⁴⁶⁷ ASCPF, ACTA, vll. 101. ff. 433 rv., 434r.

⁴⁶⁸ ASCPF, SC. SERVIA, vëll. I. ff. 261. rv., 262 rv.

Në mbledhjen plenare të Kongregatës, mbajtur më 7 dhjetor 1733, u diskutua për nevojën e rindërtimit të kishave dhe të ndërtesave të famullive në kryeipeshkvinë e Shkupit.

U vendos që sipas propozimit të kryeipeshkvit të Zarës, Zmajeviqit, t'i dërgohen 50 shkuda kryeipeshkvit të Shkupit, Summës.⁴⁶⁹

Është interesant se, si don Andrej Braciani, nuk i është drejtuar për ndihmë kryeipeshkvit Zmajeviq, por ka shkuar në Vjenë tek kardinali Kolloniq, i cili më 8 tetor 1735, ia shkroi një letër rekomandimi kardinalit kryetar të Kongregatës, Vinçenc Pjetrit, në të cilën thotë se don Andreja e meriton ndihmën për shkak të zellit e të meritave të tij para Zotit dhe për shkak të renomesë specifike që e ka te besimtarët.⁴⁷⁰ Don Andreja i ka pasur 250 piastra borxh, me të cilat i është dashur të paguajë lirimin e vet nga burgu turk. Me rekomandimin e kardinalit Kolloniq shkoi nga Vjena në Romë ku kërkoi ndihmë nga Kongregata për përhapjen e fesë që të mundet t'i shpaguajë borxhet.⁴⁷¹

Kur kryeipeshkvi Summa, më 1737 shkoi nga kryeipeshkvia për shkak të luftës, don Gjon Nikollë Kazazi, si vikar gjeneral i tij, administroi kryeipeshkvinë e Shkupit. Se në çfarë rrethanash jetoi ky dhe priftërinjtë e tjerë që kanë mbetur me besimtarët, na tregon relacioni i prokuratorit gjeneral të misioneve të françeskanëve opservantë, me të cilin ai në vitin 1738 e njofton Kongregatën për përhapjen e fesë dhe për situatën në Prefekturën françeskane të Maqedonisë, të Serbisë dhe Shqipërisë, si e kanë njoftuar atë misionarët françeskanë. Prokuratori njofton për kokëçarjet e mëdha të cilat i kanë përjetuar si misionarët ashtu edhe besimtarët katolikë, për shkak të luftës së atëhershme, duke e marrë parasysh urrejtjen dhe mllefin, që treguan osmanët ndaj besimtarëve. Të gjitha misionet nga Prefektura e Maqedonisë i shkruan prokuratorit në nëntor të vitit 1737 dhe në shkurt 1738, se misionari plak, patër Jakobi nga Castellaneta është arrestuar dhe është lidhur në pranga. Është sjellë para kadiut dhe ia kanë shkrehur revolen në gjoks, por pasi që revolja nuk punoi, françeskanit i ranë një herë me jatagan që t'ia heqin kokën. Por, françeskanit nuk iu hoq koka, pasi që shpata u ngatërrua për kapuçin e tij. Krerët popullorë të atij misioni, edhe pse ishin myslimanë, u prekën dhe u erdh keq për misionarin dhe u angazhuan që t'ia ruajnë jetën. Misionarët njëzëri njoftojnë se të gjithë, si rregulltarët ashtu edhe priftërinjtë shekullarë, do të përndiqen si nga Maqedonia ashtu edhe nga krahinat e tjera në Serbi dhe në Shqipëri. Sa i përket Serbisë me letrën e 22 marsit 1738, nga Beogradi e njoftuan prokuratorin se në Jagodinë janë varur dy priftërinj françeskanë. Ndaj vikarit gjeneral të

⁴⁶⁹ ASCPF, ACTA, vll. 103. Është shqyrtuar më 7. XII. 1733.

⁴⁷⁰ ASCPF, SOCG, vll. 685, f. 209.

⁴⁷¹ ASCPF, SOCG, vll. 685, f. 208. rv.

kryeipeshkvisë së Shkupit kanë shtënë me pushkë, kurse famullitarin e Pejës, priftin shekullar dhe misionarin e mirë, mizorisht e kanë prerë copë-copë. (Ky ishte don Andrej Sergna, vërejtje e autorit). Shumë priftërinj dhe klerikë të tjerë, si katolikë ashtu edhe skizmatikë, janë shpërndarë në të gjitha anët. Katolikët, kryesisht janë shpërndarë dhe gjenden në lajthimin më të madh. Prefekti i Prefekturës së Serbisë, besohet se ka gjetur strehim në pyje dhe se atje fshehet së bashku me shumë shqiptarë. Të gjithë janë më se të dëshpëruar. Sa i përket Shqipërisë, me letrën e shkruar në Kotorr, më 12 mars 1738, është njoftuar prokuratori se françeskani i reformuar, patër Ambroz di Cassano, gjithashtu është varur nga osmanët. Për misionarët e tjerë në Shqipëri, prokuratori nuk ka asnjë lajm, pra nuk e di se a janë fshehur apo janë vrarë, por thotë se me siguri janë djegur shumë shtëpi misionarike.⁴⁷²

Në letrën e shkruar në Gjakovë, më 29 janar 1738, vikari gjeneral, don Gjon Nikollë Kazazi, falënderon së pari gjerësisht sekretarin e Kongregatës për përhapjen e fesë, për të gjitha ato që i ka bërë Kongregata, nën angazhim të sekretarit, për kryeipeshkvinë e Shkupit. Pastaj e njofton sekretarin se ia dërgon të riun, Pjetër Berishën, duke ia rekomanduar mirësisë së tij dhe kujdesit atëror, që ta gjejë ndonjë vend për të dhe ta vendosë në kolegjin Ilirik të Loretos ose në ndonjë kolegji tjetër, si të vendosë sekretari. Sekretari e njeh mirë situatën në të cilën gjendet kryeipeshkvia e Shkupit. Pasi që kryeipeshkvi Summa nuk është më në kryeipeshkvi, don Gjoni si vikar gjeneral, ka vendosur tani që ta dërgojë urgjentisht don Pjetrin në kolegji, në emër të kryeipeshkvit të tij, por edhe për atë se sekretari ka urdhëruar ashtu, ndonëse ka pasur njerëz më të respektuar që kanë bërë lutje që në kolegji të pranohen nxënësit e tyre. Sekretarit ia shpjegon arsyen pse nuk e ka dërguar askend në kolegji para dy vitesh, kur në kolegjin Ilirik të Loretos i përfundoi studimet nxënësi i kryeipeshkvisë së Shkupit, (Andrej Lumbeski, vërejtje e autorit.) Ka qenë luftë dhe për këtë arsye që e pamundur të ndërmerret çdo gjë në atë drejtim. Kanë jetuar në aso rrethanash saqë kanë qenë në rrezikun më të madh të shkatërrimit të plotë. Nuk kanë besuar se do të kenë sukses të shpëtojnë Pjetrin dhe asnjë të ri tjetër që janë tanimë në kolegji, dhe ata mbasi kanë shpëtuar, do të mund t'i ndihmojnë atdheut të mjerë. Don Gjoni beson se sekretari do ta vendosë Pjetrin në kolegji dhe se do të kujdeset për të. Pjetri është mjaft i njohur me gramatikën latine kështu që e di se ç'janë "rregullat,

⁴⁷² ASCPF, ACTA, VII. 108., është shqyrtuar me 14. IV. 1738.

futurët, deklinacionet, grundët, supinët dhe gjërat e tjera”, të cilat ai me kohë do t’i përsosë në kolegji.⁴⁷³

Në letrën e 8 korrikut 1738 kryeipeshkvi i Zarës, Zmajeviq i thotë Kongregatës për përhapjen e fesë se ”i merituari dhe i pakrahasueshmi”, prifti don Gjon Nikolla, vikari gjeneral i Serbisë, e ka ndërmarrë, në marrëveshje me të edhe një hap, të cilin ky e lavdëron shumë si një shembull të ri të urtësisë së madhe dhe kujdesit të tij. Në gjendjen e tmerrshme të atij vendi të pafat dëshiroi ta rrëmbejë nga konfuzioni i gjithmbarshëm një djalosh shpirtmirë dhe bëri çmos që të shkojë në Zarë nëpër tokë dhe det, kështu që kryeipeshkvi ta dërgojë në kolegjin Ilirik, për çdo siguri të hirësisë së Nikollës, që ato vise të asaj mbretërie nën pushtetin osman mos të mbeteshin në të ardhmen pa misionar. Kryeipeshkvi e pranoi djaloshin mbasi i duket se, sipas karakterit, ai mund të bëhet prift i mirë i mësuesit të tij (Nikollës i cili e kishte mësuar latinisht, vërejtje e autorit) nëse Zmajeviqi do ta dërgonte në përgatitje te kardinalët e Kongregatës. Ndoshta do të mund të vendoset në kolegjin e Loretos, ku do të pasurohej posaçërisht në planin shpirtëror, ose ndoshta mund të pranohet qoftë edhe për një kohë të caktuar. Nikolla si ”i biri më i mirë i Kongregatës” e meriton këtë përpara të gjithë të tjerëve, si për vlerat e tij personale, ashtu, edhe për më tepër, për shkak të gjendjes së mjerë të fesë katolike në atdheun e tij. Kryeipeshkvi Zmajeviq ka dëgjuar, e për këtë edhe i është shkruar, në kolegjin e Loretos katër ose pesë nxënës nga ipeshkvia e Shkodrës. Nëse kjo është e vërtetë, është dëm i madh, duke e marrë parasysh ndarjen e drejtë të vendeve në kolegji, të përcaktuar me Bullën e Urbanit VIII, kujtesës së Shenjtë dhe të lavdishme. Në Shqipëri ka ipeshkvi të cilave u janë shumë më të nevojshëm nxënësit, e posaçërisht atyre të Sapës, Lezhës dhe Durrësit, të cilave u është ndarë vendi në kolegjin e Loretos, të quajtur ”përtej Drinit”, në të cilin janë shumë rrallë nxënësit nga këto ipeshkvi të cilat janë të përfshira në këtë beneficium të Urbanit. Zmajeviqi shton letrën të cilën ia kishte shkruar ”vikari shembullor i Serbisë”, i cili e meriton, si për shkak të përkushtimit të tij të madh ashtu edhe për kujdesin dhe sjelljen e tij të urtë apostolike, ndihmën më bujare të kardinalëve të Kongregatës, që të pranohen arsyet e tij të drejta dhe të forta ”të zellit të tij të shenjtë dhe mendjes provanike”. Vallë, Zoti nuk do të lejojë që katolikët e kryeipeshkvisë së Shkupit të përjetojnë fatin e njëjtë si ata në Bullgari, të cilët pas vrasjes së dy priftërinjve (don Nikollë Boshkoviçit dhe don Mihill Dobromirit, vërejtje e autorit) e vajtojnë fatin e tyre të mjerë pa pasur shpresë se do të përmirësohen rrethanat e mjera

⁴⁷³ ASCPF, SOCG, VII. 697, f. 65 rv.

të tyre për një kohë me të gjatë, sepse kanë mbetur në shkretëtirë shpirtërore pa prift e pa meshë.⁴⁷⁴

Kjo letër e Zmajeviqit u shqyrtua në mbledhjen e Kongregatës, që u mbajt më 15 shtator 1738. Në procesverbalin e mbledhjes thuhet se kryeipeshkvi i Zarës, Vinko Zmajeviqi, me letrën e 8 korrikut 1738 raportoi se prifti Gjon Nikolla, duke e parë se kryeipeshkvia për shkak të turbullirave të luftës është në rrezik të mbetet pa priftërinj, siç ka mbetur për pak edhe pa të, e ka dërguar një djalosh që të përgatitet për thirrje priftërore. Pasi rrugët qenë të mbyllura, don Gjoni për një kohë të gjatë, nuk mundi ta dërgojë asnjë djalosh ne kolegji në Loreto ose në Fermo. Tani, kryeipeshkvit Zmajeviq e ka dërguar djaloshin e quajtur Pjetër Berisha, i cili “ka përparuar shumë veçmas në gramatikën e gjuhës latine dhe ka prirje dhe është i përshtatshëm posaçërisht për studim në kolegji.” Don Gjon Nikolla bën lutje që Pjetri të pranohet në kolegjin Ilirik të Loretos si nxënës nga kryeipeshkvia e Shkupit edhe pse ky vend nuk është liruar ende, por do të lirohet pas një viti e disa ditëve. Kryeipeshkvi Zmajeviq i lut me këmbëngulje kardinalët e Kongregatës për përhapjen e fesë që djaloshi të pranohet, pasi që kryeipeshkvia e Shkupit nuk ka nevojë më të madhe se këtë, që të sigurohet, se pas një kohe të caktuar, përsëri do të fitojë ndihmë shpirtërore nga priftërinjtë dhe që mos t'i ndodhë edhe kësaj kryeipeshkvie e njëjta gjë që ndodhi në Bullgari, ku për shkak të vrasjes së dy priftërinjve, nuk mund të gjendet zëvendësimi me nxënësit e tjerë nga kolegjet e përmendura, sepse nxënës bullgarë nuk ka në këto kolegje.⁴⁷⁵

Në rekomandim të Zmajeviqit, Pjetër Berisha u pranua nxënës i Kongregatës dhe më 1738 i filloi studimet në kolegjin Ilirik të Loretos. Në regjistrin e nxënësve të këtij kolegji, më 1739 është shënuar se Pjetri është që një vit në kolegji, se është nga Gjakova, i ka 18 vjet, studion lëndët gramatikore dhe se në kolegji e zë vendin e paraparë për ipeshkvinë e Ninit.⁴⁷⁶

Don Pjetër Batuci, me letrën e 21 korrikut 1742, në emër të vet dhe të priftërinjve të kryeipeshkvisë së Shkupit, si famullitar i Prizrenit falënderon kardinalin kryetar të Kongregatës për përhapjen e fesë, për objektet liturgjike, kryqet, njesat, Agnus Dei dhe librat, që janë dërguar nëpërmes Vinko Zmajeviqit, kryeipeshkvit të Zarës, i cili është “bariu i tyre i vërtetë, pikëmbështetja e tyre e vetme, shtylla dhe ati i përbashkët i Shqipërisë, Serbisë e Bullgarisë dhe i viseve të tjera ku jetojnë katolikët e nënshtruar mizorive osmane...” Të gjitha gjërat e përmendura i solli don Gjon Nikolla, vikari gjeneral i kryeipeshkvisë së Shkupit për të cilin

⁴⁷⁴ ASCPF, SOCG, vll. 697, f.65 rv.

⁴⁷⁵ ASCPF, ACTA, vll. 108. Është shqyrtuar me 15. IX. 1738.

⁴⁷⁶ ASCPF, COLLEGI VARI, vll. 35, f. 866.

don Pjetri thotë se është “shembull i vërtetë i shërbyesit të zellshëm dhe të drejtë në Vreshtën e Zotit”. Nikollën nuk e admirojnë vetëm katolikët, por edhe skizmatikët dhe myslimanët, të cilët për shkak të veprave dhe virtyteve të tij e nderojnë shumë, gjë që nuk është e zakonshme duke pasur parasysh egërsinë, rezistencën dhe gërdinë që ata e kanë ndaj fesë katolike.⁴⁷⁷

Kryeipeshkvi Mihill Summa, më 26 gusht 1742, nga Osjeku falënderon kryeipeshkvinë e Shkupit dhe trashëgimtar të vetin e propozon don Gjon Nikollën, vikarin gjeneral të tij, i cili e meritoi këtë për meritat dhe për vuajtjet që i ka duruar. Nëse Kongregata nuk i beson atij, kryeipeshkvit, le ti drejtohet kryeipeshkvit të Zarës.⁴⁷⁸

Më 20 shtator 1742, kryeipeshkvi Zmajeviq nga Zara i shkruan Kongregatës për përhapjen e fesë se si shtojcë letrës së vet e dërgon dorëheqjen me shkrim të kryeipeshkvit Mihill Summa nga Selia e kryeipeshkvit të Shkupit. Zmajeviqi thotë se i duken të arsyeshme shkaqet të cilat Summa i përmend për pranimin e dorëheqjes së tij. Pasi ky nuk mund të kthehet në kryeipeshkvi e të mos vritet, kësaj kryeipeshkvie i është bërë i panevojshëm. Pos që do ta vritnin Summën, katolikët e atjeshëm do të përjetonin “tronditje shkatërrimtare”. Zmajeviqi dëshiron me gjithë shpirt që trashëgimtar i Summës të jetë “Zotëriu Gjon Nikolla, vikari i tij gjeneral dhe vizitatori i tashëm i Bullgarisë”. Më të mirë se ky nuk ka, pasi që ky prift ka “jetë të shenjtë dhe është më i arsimuari dhe më i arsyeshmi” prej të gjithëve, që janë në krahinën e cila është nën mbikëqyrjen e Zmajeviqit. Zmajeviqi më tutje thotë: “Zoti le t'i frymëzojë Shkëlqesitë e Juaja, sepse Nikolla do t'i përshtatet më së miri shpëtimit të asaj kryeipeshkvie, që ajo, e cila është shkretuar aq mizorisht në luftën e kaluar, të ekzistojë edhe më tutje, sipas mrekullisë së provanisë së Zotit dhe zellit të shenjtë e dashurisë së vikarit tepër të merituar, Nikollës”.⁴⁷⁹

Duke e falënderuar për të dytën herë për kryeipeshkvinë e Shkupit, kryeipeshkvi i Shkupit, Mihill Summa i shkruan nga Osjeku, më 29 janar 1743, Kongregatës për përhapjen e fesë dhe lut që dorëheqja e tij të pranohet, sepse ai kështu do ta qetësojë ndërgjegjen e vet, kurse populli do ta fitojë bariun e vet, e vazhdon: “Shkëlqesia Juaj nuk do të marrë mundin duke e kërkuar personin në zemrën time, sepse nuk do të gjejnë më të mirë, në tërë kryeipeshkvinë, se don Gjon Nikollën, vikari i tanishëm gjeneral i Shkupit, të cilin e njohin mirë Shkëlqesitë Tuaja. Ai është njeri shembullor, i zellshëm në misionet, i dashur si te katolikët ashtu edhe te myslimanët, i udhëzuar në zakonet e atyre viseve, në

⁴⁷⁷ ASCPF, SC. SERVIA, vll. 1, f. 357.

⁴⁷⁸ ASCPF, SOCG. vll. 715, ff. 243v, 244.

⁴⁷⁹ ASCPF, SOCG., vll. 715., f. 240.

mënyrë të përsosur e flet gjuhën turke, kroate dhe shqipe. Nuk është larguar nga populli, duke ndenjur me katolikët në të gjitha rreziqet dhe duke e vizituar kryeipeshkvinë gjatë kohës kur nuk kam qenë prezent. Meqenëse ka 10 vjet që ai është vikar gjeneral, Shkëlqesitë Tuaja duke e avancuar në kryeipeshkëv të Shkupit, atij populli do t'ia japin një bari të mirë. Mos të mendojnë Shkëlqesitë e Juaja se e kam rekomanduar Nikollën e përmendur me aq zjarr, i nxitur nga ndonjë motiv tjetër, përveç tij se e marr obligim të vepror në mënyrë të drejtë për shkak të meritave të atij i cili për shkak të vuajtjeve që është ekspozuar, ka merituar edhe më shumë se kryeipeshkvinë e Shkupit. Por, nëse Shkëlqesitë Tuaja nuk ju besojnë fjalëve të mia, le të denjohen për t'u informuar tek shumë i ndrituri imzot kryeipeshkvi i Zarës dhe do të shohin se e flas të vërtetën..."⁴⁸⁰

Në mbledhjen plenare, mbajtur më 12 maj 1743 Kongregata për përhapjen e fesë vendosi ta propozojë don Gjon Nikollë Kazazin kryeipeshkëv të Shkupit. Në dekretin e Kongregatës thuhet se pas dorëheqjes së kryeipeshkvit të famshëm të Shkupit, Mihill Summës, të cilën ai e dorëzoi me shkrim dy herë, të cilën e arsyetoi mirë, më 26 gusht 1743 ai shkarkohet nga detyra e kryeipeshkvit të Shkupit. Për shkak të rrethanave të posaçme, e në bazë të informatave dhe rekomandimit të të deleguarit apostolik për misionet në Serbi, kryeipeshkvit të Zarës, kardinalët e Kongregatës vendosën ta këshillojnë papën që ky ta pranojë dorëheqjen e Summës dhe ta emërojë për kryeipeshkëv të Shkupit don Gjon Nikollën, priftin shekullar, ish-nxënësin e kolegjit Ilirik në Fermo dhe Loreto, vikarin gjeneral të kryeipeshkvisë së Shkupit dhe vizitatorin e misionëve në Bullgari. Nikolla e kreu shumë mirë vizitën në Bullgari dhe është i devotshëm, i zellshëm, i arsyeshëm, i angazhuar në fenë katolike, i arsimuar e i pajisur me virtyte të tjera dhe më i rekomanduari nga kryeipeshkvi që jep dorëheqje dhe nga kryeipeshkvi i Zarës.

Sekretari i Kongregatës Filip Monti ia dorëzoi papës në audiencën e mbajtur më 20 maj të vitit 1743, propozimin e Kongregatës, kurse papa këtë propozim e miratoi dhe urdhëroi që të bëhet çdo gjë që është e nevojshme për këtë emërim. Dekreti i Kongregatës e mban datën e 8 gushtit 1743, kurse e ka nënshkruar sekretari i përmendur i saj, Filip Monti.⁴⁸¹ Në audiencën e mbajtur më 20 gusht 1743 papa Benedikti XIV e angazhoi kardinalin Vinçenc Pjetrin që ta udhëheqë këtë proces dhe që këtë emërim ta shpallë dhe ta arsyetojë në konzistorium.⁴⁸²

⁴⁸⁰ ASCPF, SOCG, vll. 715, ff. 241 v, 242.

⁴⁸¹ Asv, PROCESSUS DATARIAE, vll. 120., f. 347rv.

⁴⁸² Po aty f. 375.

Prej vitit 1743 deri më 1745 nuk kemi hasur në asnjë dokument nga i cili do të shihej se kryeipeshkvi Zmajeviq vendos, rekomandon ose këshillon për gjërat që kanë të bëjnë më kryeipeshkvinë e Shkupit. As në regjistrin e përgjithshëm të akteve të Kongregatës për përhapjen e fesë, në këtë interval kohor, nuk është shënuar asnjë intervenim i tij. Megjithatë, në testamentin e tij kryeipeshkvi Zmajeviq nuk i harron viset të cilat i ka mbikëqyrur si i deleguar apostolik i Kongregatës për përhapjen e fesë. Ai ka përcaktuar që gjysma e kamatave të trashëgimisë së tij të jepet për ndihmë ipeshkviëve dhe misioneve të Shqipërisë, kurse gjysma tjetër e kamatave të jepet për bërjen e meshave për shpirtin e tij, e këto mesha do t'i shërbejnë priftërinjtë, ish nxënësit e kolegjit Urban.⁴⁸³

Burimet dhe literatura:

I. Arkivi i Kongregatës për Ungjillizimin e popujve ose "për përhapjen e fesë". (ASCPF)

- 1) Acta Sacrae Congregationis (ACTA)
- 2) Collegi Vari (Collegi Vari)
- 3) Indice Generale degl 'Atti della Sag Congregazione 1688-1745. Albania, Servia.
- 4) Scritture Originali riferite nelle Congregazioni Generali (SOCG)
- 5) Scritture riferite nei Congressi (SC)

II. Arkivi sekret i Vatikanit (ASV)

- 1) S. Congr. Concilii, Relationes, Scopien., vol. 728, Visita 1716.
- 2) Processus Datariae, vol. 75., 79., 120.

III. Literatura

Pavao Butorac, *Vicko Zmajević (1670-1745)*, Hrvatska Smotra, Viti XV., nr. 3, Zagreb, 1928.

⁴⁸³ ASCPF, Indice Generale, Viti 1745. ALBANIA, Varie.

Faksimile